



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me karakter Profesional në  
“Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike”  
Universiteti “Polis”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. As. Ana Ktona

Dr. Alketa Grepcka

Gusht/2021

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Për Programin e studimit jouniversitar me karakter profesional në "Mirëmbajtje rrjete**  
**Kompjuterike"**

|      |   |  |
|------|---|--|
| Nr.  |   |  |
| 1    | IAL aplikues:   | Universiteti "POLIS"   |
| 2    | Njësia bazë që e ofron:                                   | Departamenti i Kërkimit të Aplikuar<br>(Fakulteti i Kërkimit dhe Zhvillimit)               |
| 3    | Emërtimi i programit të studimit:                         | Program studimi jouniversitar me karakter profesional në "Mirëmbajtje Rrjete kompjuterike" |
| 4    | Urdhëri/VKM i licencimit:                                 | UMASR Nr. 814, datë 21.12.2018   |
| 5    | Urdhëri/VKM i riorganizimit:                              | -  |
| 6    | Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:             | -  |
| 7    | Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës:                     | -  |
| 8    | Cikli i studimit:   | Program studimi jouniversitar me karakter profesional, mbi shkollën e mesme                |
| 9    | Kohëzgjatja e programit të studimit:                      | 2 vite   |
| 10   | Kreditet në total (ECTS):                                 | 120 ECTS   |
| 11   | Forma e studimit:   | Me kohë të plotë   |
| 12   | Gjuha (shqip/tjetër):                                     | Shqip  |
| 13   | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | Programi nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera                               |
| 13.1 | • Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):                 | -  |
| 13.2 | • Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):                   | -  |
| 14   | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:            | Niveli 5   |
| 15   | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:          | 7 PAE / 7 PAK (ngarkesa mësimore mbështete nga PAE në masën mbi 70%)                       |
| 16   | Numri i studentëve (për tre vite):                        | 59   |
| 17   | Komente / të tjera:                                       |  |

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Polis është Institucion i Arsimit të Lartë jo publik, i cili është licencuar me VKM Nr. 698, datë 11.10.2006 si shkollë e lartë universitare, jopublike "Universiteti Polis". Me VKM nr. 746, datë 24.10.2012 miratohet ndryshimi i statutit nga "Shkollë e Lartë Universitare" në "Universitet".

Universiteti "Polis" është riakredituar me Vendimin e bordit të Akreditimit, VBA Nr. 113, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 6 vite, deri më 14.12.2023. Universiteti "Polis" përbëhet nga 3 fakultete dhe 1 Qendër Studimore:

1. Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn
2. Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban
3. Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim
4. Qendra Studimore Ndërdisciplinore Kërkimore e Inovacionit

Programi i studimit jouniversitar me karakter profesional në "Mirëmbajtje Rrjete kompjuterike" (më tej MRK) është hapur me urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 814, datë 21.12.2018 dhe zhvillohet në Departamentin Kërkimi i Aplikuar në Fakultetin e Kërkimit dhe Zhvillimit.

GVJ konstaton që IAL "POLIS" zotëron të gjithë kuadrin ligjor dhe strukturat drejtuese dhe mbështetëse për të garantuar një mirëfunksionim të programit të studimit.

GVJ konstaton që programi i studimit jouniversitar me karakter profesional DP në "Mirëmbajtje Rrjete kompjuterike" është organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 2 vite dhe në total 120 kredite. GVJ konstaton se programi MRK nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara synon *marrjen e njohurive në sisteme të mirëmbajtjes së rrjeteve, aftësi praktike për të përdorur teknikat aktuale, aftësi dhe mjetet e nevojshme për praktikën e informatizimit, kreativitetit dhe inovacionit.*

Programi studimit MRK ofrohet në gjuhën shqipe, me 120 kredite, në 2 vite akademike, 4 (katër) semestra. Kreditet janë të llogaritura sipas sistemit ECTS. Veprimtaria akademike e këtij programi ka filluar në vitin akademik 2019-2020.

GVJ konstaton se dosja e programit të studimit MRK është e plotë dhe përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Frekuentimi ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit dhe syllabuset. GVJ konstaton se programi i studimit MRK ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi. Raportet midis formimit teorik dhe praktik janë të përshtatshme për arritjen e objektivave formuese dhe formimin e specialistëve të aftë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të rrjeteve kompjuterike.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm (më tej GVJ) të përcaktuar me Urdhër Nr.9 datë 22.01.2021 të ASCAL, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë, aplikuar nga Universiteti “POLIS”, Tirane dhe në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku janë përcaktuar kodi i cilësisë dhe standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Universiteti “POLIS”, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit jouniversitar me karakter profesional në "Mirëmbajtje Rrjete kompjuterike".

Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit MRK, kanë realizuar vizitat në datën 30 Prill 2021, në Universitetin “POLIS”, sipas veprimtarive të parashikuara në axhendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit MRK, bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standardeve shtetërore të cilësisë nga Universiteti “POLIS”.

Zgjatja e periudhës së hartimit të këtij raporti u bë për shkak të kushteve të jashtëzakonshme të shkaktuar nga situata e vështirë e COVID-19.

Koordinatori teknik i ASCAL në këtë procedurë është ME. Renata Qatipi.

Me datë 25.08.2021, nëpërmjet AMS, Universiteti POLIS është njohur me Draft Raportin e vlerësimit të jashtëm, hartuar nga GVJ.

Universiteti POLIS më datë 25.08.2021, përcjell përgjigjen për Draft RVJ, nëpërmjet AMS dhe me shprehje Nr. 716/21 Prot, datë 25.08.2021. Në këtë shkresë Institucioni deklaroi se, Raporti është korrekt dhe vlerësojmë punën e ekspertëve të vlerësimit të jashtëm dhe nuk kemi komente mbi draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Profesional në Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike”.

Në këtë rast Draft Raporti kthehet në Raport përfundimtar

**Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL**

| <b>Standardi I.1</b>   |  |
|--|--|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.</b>  |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi</b>   |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>  | <p>Organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike është në përputhje me objektivat dhe strategjinë e Universitetit POLIS. Programi i studimit me karakter profesional “Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike” është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të IAL, ku nga strategjia e tij citojmë: <i>Misioni i U_POLIS është sigurimi i “Njohurive, Teknologjisë dhe Lidërshit për zhvillimin dhe inovacionin.”</i></p> <p><a href="http://www.universitetipolis.edu.al/sites/default/files/pdf/Strategjia%20e%20Zhvillimit/Strategjia%20e%20Zhvillimit%202014-2020.pdf">http://www.universitetipolis.edu.al/sites/default/files/pdf/Strategjia%20e%20Zhvillimit/Strategjia%20e%20Zhvillimit%202014-2020.pdf</a></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Strategjia%20e%20Zhvillimit/Strategjia%20e%20Zhvillimit%202014-2020.pdf</a></li> <li>• <a href="#">Development%20Strategy%202021-2026.pdf</a></li> </ul> <p>[dok gjatë vizitës Strategjia e POLIS 2021-2026]</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>    | <p>Programi i studimit “Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike” ofrohet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit Polis. GVJ konstaton se statuti dhe rregullorja e institucionit theksojnë qartë drejtimit prioritar akademike. Ndër objektivat e Universitetit Polis janë: <i>a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe të aplikuar si dhe inovacionit; b) të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në fushën e dizajnit, arkitekturës dhe inxhinierisë, shkencave të territorit, menaxhimit dhe politikave të zhvillimit; ç) të ofrojë mundësinë e formimit profesional dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës;</i></p> <p>Neni 32 i Statutit të Universitetit Polis demonstroi se programet e studimit hartohen dhe ofrohen sipas përcaktimeve të Statutit të Universitetit Polis.</p> <p>[Statuti i Universitetit POLIS, nenet 2, 3 dhe 32] [dok DVV Aneks 4, Rregullore e Përgjithshme]</p>                          |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p> | <p>Programi 2-vjeçar me karakter profesional “Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike”, ofrohet nga Departamenti i Kërkimit të Aplikuar, në Fakultetin për Kërkim dhe Zhvillim. Ai ofrohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në statutin e Universitetit Polis. Bazuar në shqyrtimin e dokumentacioneve të dorëzuara nga GVB dhe informacionit të marrë gjatë vizitës së zhvilluar, në intervistën me drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë GVJ konstatoi se programi i studimit ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë që e ofron këtë program.</p> <p>[Statuti i Universitetit POLIS, nenet 2, 3] [Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS]</p> <p><a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1929">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1929</a></p>  |

|   |   |                             |                              |
|---|---|-----------------------------|------------------------------|
|   | http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/41   |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.  | <p>Universiteti Polis ka bërë një studim tregu, ku ka marrë në shqyrtim Strategjinë e tregut të punës dhe arsimit 2014-2020, vrojtime statistikore sistematike (tremujore dhe vjetore), dhe studime/vrojtime specifike orientuar drejt inovacionit dhe teknologjisë. Në të ai ka evidentuar, sipas dokumentacioneve të marra në shqyrtim gjatë studimit të tregut, se ekziston një mospërputhje midis nevojave për aftësi nga bizneset dhe fushave të studimit nga të diplomuarit. Përveç kesaj, programet/kurrikulat universitare janë kryesisht teorike dhe kanë mungesa në krijimin dhe kultivimin të aftësive praktike. Ka shumë pak të diplomuar në fusha shumë të kërkuara si IT, programues, etj.</p> <p>[Vizita Në Institucion: 1. Studim Tregu]</p>  |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.  | <p>Universiteti Polis ka analizuar në studimin e tregut dhe informacione nga INSTAT të vitit 2020. Ai ka evidentuar bazuar në analizë se ritmet e rritjes vjetore të numrit të bizneseve, që operojnë në fushën e teknologjisë si dhe shërbime të tjera informacioni-TIK janë shumë më të larta se rritja vjetore e numrit të bizneseve/ndërmarrjeve në nivel vendi, respektivisht 37% përkundrejt 8.4%.</p> <p>Në Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit përcaktohet se institucioni mbledh në mënyrë të vazhduar informacion nga studentët e diplomuar dhe gjurmon punësimin e tyre dhe/ose avancimin në karrierë. Ky proces nuk është realizuar për studentët e programit 2-vjeçar me karakter profesional “Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike”, pasi nuk është diplomuar brezi i parë i tij.</p> <p>[Vizita Në Institucion: 1. Studim Tregu] [dok DVV Aneks 23. Mendime_tregu i punes] [dok DVV Aneks 4, Rregullore e Pergjithshme]</p>   |                             |                              |
| <b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | <p>Studimet e realizuara nga Universiteti Polis përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës. Universiteti Polis ka marrë mendimin e tregut të punës mbi kurrikulën e programit 2-vjeçar me karakter profesional “Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike” dhe përshtatjen me tregun. Ky mendim ka rezultuar shumë pozitiv. Sipas RVB, në Shtator 2020 u realizua një aktivitet me operatorët e tregut të punës i cili synonte të mbidhte të dhëna nga ky treg. Në këtë webinar të zhvilluar online morën pjesë kompani të ndryshme, si Abissnet, Infosoft, Albtelekom, CSP, etj.</p> <p>Gjithashtu në studimin tregut të realizuar ka informacion mbi mundësitë e punësimit të studentëve dhe zhvillimet e pritshme në sektorin IT të cilat rezultojnë shumë të mëdha. Ritmet e rritjes vjetore të numrit të bizneseve për fushën e IT, rezultojnë shumë më të larta se rritja vjetore e numrit të bizneseve në fushat e tjera në nivel vendi respektivisht 37% përkundrejt 8.4%.</p> <p>Studimi mbi punësimin real të studentëve të diplomuar në programin 2-vjeçar me karakter profesional “Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike”, nuk është realizuar pasi nuk është diplomuar brezi i parë i tij.</p> <p>[Vizita Në Institucion: 1. Studim Tregu] [dok DVV Aneks 23. Mendime_tregu i punes]</p> |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b>  | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |   |                             | X                            |

**Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

| Kriteret  | Vlerësimi  |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>  | <p>Universiteti Polis funksionon në bazë të një strukture organizative, në të cilën secila prej njërive mban përgjegjësitë e saj. Detyrat janë të ndara qartë dhe të specifikuara. Stafit i programit të studimit ka të përcaktuar qartë detyrat dhe rolet, në përputhje me objektivat dhe qëllimet e programit të studimit. Departamenti ka bashkëpunime të frytshme me departamente të tjera në funksion të realizimit të programit. Programi i studimit është realizuar edhe me pedagogë të departamenteve të tjera përveç atyre që janë pjesë e Departamentit të Kërkimit të Aplikuar. Bashkëpunimet janë të vazhdueshme dhe me njësitë administrative si me Njësinë e Pranimeve/Marketimit, Bibliotekën, Sekretarinë Mësimore etj</p> <p>[Dok DVV Aneks 5. Struktura Organizative; Aneks 4. Rregullore e Përgjithshme; Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar); [dok DVV Aneks 41. Tabelat permbledhese _ASCAL MRK;]</p> <p><a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1933">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1933</a></p> <p><a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1929">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1929</a></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p> | <p>Universiteti Polis ka bashkëpunime të shumta, si në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta kërkimore e didaktike ashtu dhe në shkëmbime të vazhdueshme dhe mobilitetit mes stafit akademik dhe studentëve. Bazuar në dokumentin ‘<i>Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit</i>’ bashkëpunimet e zyrtarizuara janë në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor, kryesisht të praktikave profesionale. Për programin e studimit MRK, marrëveshja me fokus praktikën e studentëve është ajo me kompaninë CSP. Gjatë vizitës në institucion drejtuesit dhe GVB u shpreh se ishin në proces të nënshkrimit të marrëveshjes me Swiss Contact për të kthyer programin në program dual.</p> <p>Universiteti Polis ka shumë marrëveshje bashkëpunimi me punëdhënës të cilat janë në funksion të realizimit të praktikave profesionale. Marrëveshja me kompaninë CSP ka mundësuar kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës për studentët e programit të studimit MRK.</p> <p>[Dok DVV Aneks 6. Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit;]</p> <p><a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/23">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/23</a></p>                                      |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njëria përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>  | <p>Studentët e programit kanë realizuar praktikën e tyre në kompaninë CSP. Sipas RVB, nga pyetësoret rezulton se 98% e studentëve vlerësoan maksimalisht internshpin lidhur me organizimin, përgatitjen e stafit të inxhinierëve të kompanisë, temat e trajtuara, etj</p> <p>Gjithashtu studentët e programit kanë realizuar disa aktivitete online me qasje praktike. Është plainifikuar të hartohet një raport lidhur me efikasitetin e këtyre bashkëpunimeve dhe përfitimin e studentëve prej tyre në përfundim të vitit të dytë të brezit të parë të këtij programi.</p>   |

|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|   | [Dok DVV Aneks 25. Aktivitete/konferenca online; Aneks 11. Kalendari i Praktikave 2019-2020]  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve. | <p>GVJ konstaton se përpjekjet e Universitetit Polis për punësimin e studentëve të diplomuar janë maksimale. Zyra e Mbeshtetjes së Studenteve dhe Keshillimit të Karrieres (ZMSKK) ka ndër detyrat kryesore informimin e studentëve përpara dhe gjatë ndjekjes së studimeve, njohjen paraprake me tregun e punës, orientimin e tyre në këtë treg si dhe ndërmjetësimin e lehtësimit të procesit të punësimit, aty ku është e mundur.</p> <p>Përveç mbështetjes nga kjo zyrë studentët e programit MRK marrin këshillime dhe orientime lidhur me hapësirat, kërkesat dhe mundësitë e punësimit, si edhe vetë punësimin, nga pedagogët e programit të cilët janë të angazhuar në profesionin e tyre në kompani të fushës.</p> <p>Universitetit POLIS, është pjesëmarrës në projektin GRADUA (Erasmus+ KA2) i cili lehtëson krijimin e urave lidhëse midis të diplomuarve dhe tregut të punës.</p> <p><a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=en/node/2260">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=en/node/2260</a></p> <p><a href="https://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57">https://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57</a></p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  |   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |   |                              |                             | X                            |

### Standardi I.3

**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.**

| Kriteret  | Vlerësimi   |
|---|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).   | <p>Programi studimit MRK është në përputhje me Nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (ka 8 Nivele), aprovuar me Ligjin Nr. 10247, datë 04.03.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”/amenduar/2018.</p> <p>Bazuar në rregulloren e programit dhe planin mësimor të tij programi i studimit MRK, përmban 120 kredite, sipas sistemit ECTS. Një krediti të formimit i korrespondon 25 orë mësimore që përbëhen nga orë mësimore për transmetim dijes në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, etj.) dhe në orë për punë individuale të studentit. Kohëzgjatja e tij normale është dy vite akademike dhe është i organizuar në lëndë të vlerësuara me kredite.</p> <p>[Dok DVV Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar); Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar]</p> |
| <b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithëpërfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. | <p>Programi i studimit me karakter profesional në “Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike” plotëson nevojat e studentëve, që të përfitojnë të gjitha njohuritë e nevojshme të specializuara teorike dhe praktike. Synimi parësor i këtij programi është të krijojë profesionistë në fushën e IT-se dhe specififikisht në fushën e mirëmbajtjes së rrjeteve kompjuterike.</p> <p>[Dok DVV Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar); Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar]</p>  |
| <b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit  | Programi i studimit me karakter profesional në “Mirëmbajtje Rrjete  |



| <p>me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>  | <p>Kompjuterike”, nëpërmjet Lëndëve bazë (18 kredite), Lëndëve karakterizuese (66 kredite), Lëndëve ndërdisiplinore/integruese (18 kredite), Lëndëve plotësuese, Praktikës profesionale (12 kredite) dhe Detyrimeve përmblylëse (6 kredite), synon pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik. Programi MRK synon të japë njohuri formuese dhe praktike bazë mbi çështje dhe problematika që lidhen me strukturimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve kompjuterike, sistemet e softuerëve, infrastrukturën e networkut si dhe me sistemin e menaxhimit të të dhënave në përgjithësi.</p> <p>[Dok DVV Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar); Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar]</p>   |                                   |                                     |          |                                     |          |                                    |  |     |     |     |     |     |     |          |   |  |   |   |   |   |            |   |   |   |   |   |   |               |   |   |   |   |   |   |      |   |   |   |   |   |   |  |          |          |          |          |          |          |          |                        |  |  |  |  |  |
|---|---|-----------------------------------|-------------------------------------|----------|-------------------------------------|----------|------------------------------------|--|-----|-----|-----|-----|-----|-----|----------|---|--|---|---|---|---|------------|---|---|---|---|---|---|---------------|---|---|---|---|---|---|------|---|---|---|---|---|---|--|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|------------------------|--|--|--|--|--|
| <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>                                     | <p>Programi MRK ofron një lëndë ndërdisiplinore dhe integruese, ‘Sipërmarrja dhe Biznesi’ që i vjen në ndihmë studentëve në mënyrë që të mësojnë të zhvillojnë aftësitë e tyre për të menaxhuar veprimtaritë dhe aktivitetin e tyre profesional.</p> <p>Programit i studimit MRK, synon zhvillimin dhe pajisjen e studentëve me aftësitë dhe kompetencat e duhura në fushën mirëmbajtjes se rrjeteve kompjuterike ku përfshihet dhe zgjidhja e problematikave të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me networkun, (monitorimi, diagnostikimi, mirëmbajtja, konfigurimi, etj,) të mjaftueshme për t’u përballur me situata të ndryshme e të ndryshueshme gjatë punës së tyre.</p> <p>[Dok DVV Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar); Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar]</p>  |                                   |                                     |          |                                     |          |                                    |  |     |     |     |     |     |     |          |   |  |   |   |   |   |            |   |   |   |   |   |   |               |   |   |   |   |   |   |      |   |   |   |   |   |   |  |          |          |          |          |          |          |          |                        |  |  |  |  |  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p> | <p>Programi i studimit me karakter profesional në “Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike” mbulohet nga lektorë me tituj dhe grada në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet e tij mbështetëse. Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim pranë Universitetit Polis ka në përbërje të tij dy departamente: Departamenti i Kërkimit Shkencor (DKK) dhe Departamentin e Kërkimit të Aplikuar (DKA) si dhe Qendra e Burimeve dhe Informacionit (QBI).</p> <p>Tabela e mëposhtme jep numrin e personelit akademik dhe titujt/gradat, <b>për vitin akademik 2020-2021:</b></p> <table border="1" data-bbox="568 1473 1385 1818"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim</th> <th colspan="2">Departamenti i Kërkimit Shkencor</th> <th colspan="2">Departamenti i Kërkimit të Aplikuar</th> <th colspan="2">Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Profesor</td> <td>4</td> <td></td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Doktor/Docent</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>6</td> <td>4</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td></td> <td><b>8</b></td> <td><b>3</b></td> <td><b>8</b></td> <td><b>9</b></td> <td><b>7</b></td> <td><b>0</b></td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td colspan="6" style="text-align: center;"><b>23 PAE / 12 PAK</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Në dy vitet e fundit stafi akademik në Departamentin që drejton programin e studimit ka qenë si më poshtë:</p> | Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim | Departamenti i Kërkimit Shkencor    |          | Departamenti i Kërkimit të Aplikuar |          | Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë |  | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK | Profesor | 4 |  | - | - | - | - | Prof. Asoc | - | 1 | - | - | - | - | Doktor/Docent | 3 | 1 | 3 | 3 | 3 | - | Msc. | 1 | 1 | 5 | 6 | 4 | - |  | <b>8</b> | <b>3</b> | <b>8</b> | <b>9</b> | <b>7</b> | <b>0</b> | Gjithsej | <b>23 PAE / 12 PAK</b> |  |  |  |  |  |
| Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim   | Departamenti i Kërkimit Shkencor  |                                   | Departamenti i Kërkimit të Aplikuar |          | Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë  |          |                                    |  |     |     |     |     |     |     |          |   |  |   |   |   |   |            |   |   |   |   |   |   |               |   |   |   |   |   |   |      |   |   |   |   |   |   |  |          |          |          |          |          |          |          |                        |  |  |  |  |  |
|   | PAE   | PAK                               | PAE                                 | PAK      | PAE                                 | PAK      |                                    |  |     |     |     |     |     |     |          |   |  |   |   |   |   |            |   |   |   |   |   |   |               |   |   |   |   |   |   |      |   |   |   |   |   |   |  |          |          |          |          |          |          |          |                        |  |  |  |  |  |
| Profesor  | 4   |                                   | -                                   | -        | -                                   | -        |                                    |  |     |     |     |     |     |     |          |   |  |   |   |   |   |            |   |   |   |   |   |   |               |   |   |   |   |   |   |      |   |   |   |   |   |   |  |          |          |          |          |          |          |          |                        |  |  |  |  |  |
| Prof. Asoc  | -   | 1                                 | -                                   | -        | -                                   | -        |                                    |  |     |     |     |     |     |     |          |   |  |   |   |   |   |            |   |   |   |   |   |   |               |   |   |   |   |   |   |      |   |   |   |   |   |   |  |          |          |          |          |          |          |          |                        |  |  |  |  |  |
| Doktor/Docent   | 3   | 1                                 | 3                                   | 3        | 3                                   | -        |                                    |  |     |     |     |     |     |     |          |   |  |   |   |   |   |            |   |   |   |   |   |   |               |   |   |   |   |   |   |      |   |   |   |   |   |   |  |          |          |          |          |          |          |          |                        |  |  |  |  |  |
| Msc.  | 1   | 1                                 | 5                                   | 6        | 4                                   | -        |                                    |  |     |     |     |     |     |     |          |   |  |   |   |   |   |            |   |   |   |   |   |   |               |   |   |   |   |   |   |      |   |   |   |   |   |   |  |          |          |          |          |          |          |          |                        |  |  |  |  |  |
|   | <b>8</b>  | <b>3</b>                          | <b>8</b>                            | <b>9</b> | <b>7</b>                            | <b>0</b> |                                    |  |     |     |     |     |     |     |          |   |  |   |   |   |   |            |   |   |   |   |   |   |               |   |   |   |   |   |   |      |   |   |   |   |   |   |  |          |          |          |          |          |          |          |                        |  |  |  |  |  |
| Gjithsej  | <b>23 PAE / 12 PAK</b>  |                                   |                                     |          |                                     |          |                                    |  |     |     |     |     |     |     |          |   |  |   |   |   |   |            |   |   |   |   |   |   |               |   |   |   |   |   |   |      |   |   |   |   |   |   |  |          |          |          |          |          |          |          |                        |  |  |  |  |  |

|  |  |                              |                             |                              |     |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|-----|
|  | Stafi i Departamentit të Kërkimit të Aplikuar  | Viti akademik 2019-2020      |                             | Viti akademik 2020-2021      |     |
|  |  | PAE                          | PAK                         | PAE                          | PAK |
|  | Profesor   | -                            |                             | -                            |     |
|  | Prof. Asoc   | -                            |                             | -                            |     |
|  | Doktor/PhD   | 5                            | 1                           | 3                            | 3   |
|  | Msc.   | 2                            | 5                           | 5                            | 6   |
|  |  | 7                            | 6                           | 8                            | 9   |
|  | Drejtuesi i Departamentit, që mbështet këtë program studimi ka gradën “Dr”, në përputhje me Ligjin 80/2015, neni 45, pika 3.   |                              |                             |                              |     |
|  | [Dok DVV Aneks 41. Tabelat permbledhese_ASCAL MRK]   |                              |                             |                              |     |
| <b>Kriteri 6.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit. | Programi i studimit MRK ka të përcaktuar objektivat që lidhen me formimin profesional të studentëve, aftësitë dhe kompetencat profesionale që ata përfitojnë në përfundim të studimeve dhe çdo karakteristikë tjetër që lidhet me profilin profesional të programit. Në rregulloren e tij është përcaktuar se Universiteti Polis synon të ofrojë një program të ciklit parauniversitar me karakter profesional Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike. Referuar Evidencës Aneks 12, programi i studimit MRK, është ideuar për tu dhënë studentëve njohuritë bazë mbi çështje dhe problematika që lidhen me strukturimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve kompjuterike, sistemet e softuereve, me infrastrukturën e networkut si dhe me sistemin e menaxhimit të të dhënave në përgjithësi. |                              |                             |                              |     |
|  | [Dok DVV Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar)];  |                              |                             |                              |     |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   |  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |     |
|  |  |                              |                             | X                            |     |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>  |  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |     |
|  |  |                              |                             | X                            |     |

## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

### Standardi II.1

**Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit**

| Kriteret   | Vlerësimi   |
|--|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, | Rregullorja e programit të studimit MRK në Universitetin Polis përmban informacionin e nevojshëm si objektivat formues të programit, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën dhe përmbajtjen dhe mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Neni 1. Objektivat e programit të studimit <ul style="list-style-type: none"> <li>○ 1.1 Objektivat formuese të programit të studimit</li> </ul> </li> </ul> |

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 [04] 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 10

|  |  |
|--|--|
| <p>përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>○ 1.2 Mundësitë për punësim</li> <li>● Neni 2. Niveli i studimit/cikli i studimi</li> <li>● Neni 3. Forma e Studimeve</li> <li>● Neni 4. Veprimtaritë formuese, Kreditet</li> </ul> <p>Rezultatet e pritshme të të nxënit si dhe objektivat formuese, dhe fushat e mundshme të punësimit përfshihen edhe në materialet promovuese të programit të aksesueshme në internet. Informacionet mbi përmbajtjen e lëndëve gjenden në syllabuset e çdo lënde.</p> <p>Programi i studimit MRK nuk ka ende studentë të diplomuar.</p> <p>[Dok DVV Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar); Aneks 10. Syllabuse MRK;] [PROGRAME_STUDIMI/Rrjete_kompjuterike_al.pdf]</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33</a></li> <li>● <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/sites/default/files/pdf/">http://www.universitetipolis.edu.al/sites/default/files/pdf/</a></li> </ul>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>          | <p>Programi i studimit MRK ka një kohëzgjatje 2 (dy) vite akademike dhe është i ndarë në katër semestra dhe 60 kredite në vit. Bazuar në planin mësimor të vënë në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ 15 % (ose 18 Kredite) janë Lëndë bazë (Kategoria A)</li> <li>▪ 55% (ose 66 Kredite) janë Lëndë karakterizuese (Kategoria B)</li> <li>▪ 15% (ose 18 Kredite) janë Lëndë ndërdisipli/integruese (Kategoria C)</li> <li>▪ 10% (ose 12 Kredite) janë Lëndë plotësuese (Kategoria D)</li> <li>▪ 5% (ose 6 Kredite) janë Detyrime përmbyllëse (Kategoria E)</li> </ul> <p>Ky program është në përputhje me VKM Nr.879, date 18.12.2019. Plani mësimor i programit të studimit MRK organizohet mbështetur në Deklaratën e Bolonjës, ku thelbësor mbeten kreditet ECTS (European Credit Transfer System), që bëjnë të mundur matjen e të mësuarit dhe arritjet e studentit, si dhe ka në qendër ngarkesën e punës që studenti duhet të kryejë për të arritur objektivat e programit të studimit.</p> <p>[Dok DVV Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar); Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar]</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p> | <p>Plani mësimor i programit profesional Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike është i ndarë në katër semestra dhe ka të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me lëndët për çdo semestër, pedagogun përgjegjës për këtë lëndë, ngarkesën mësimore, aktiviteteve formuese, orët në auditor, ndarjen e orëve të leksionit dhe semestrave, kreditet e gjithashtu orët e studimit.</p> <p>Programi i studimit përbëhet nga 22 lëndë (përfshirë këtu praktikat profesionale si dhe projektet finale) në 2 (dy) vite. Lëndët kanë nga 3 (tre) ose 6 (gjashtë) kredite.</p> <p>[DVV Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar]</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të</p>   | <p>Për secilën lëndë është hartuar syllabusi i detajuar, sipas përcaktimit të VKM Nr.879, date 18.12.2019. Syllabuset për çdo lëndë, pasqyrojnë këta elementë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Emërtimi i lëndës/modulit;</li> <li>▪ Viti/semestri kur zhvillohet lënda;</li> </ul>   |

|  |  |                             |  |
|--|--|-----------------------------|--|
| <p>gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën;</li> <li>▪ Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë;</li> <li>▪ Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik;</li> <li>▪ Ngarkesa në orë në auditor si dhe në ECTS;</li> <li>▪ Format e vlerësimit të studentëve dhe raportet midis tyre;</li> <li>▪ Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse.</li> </ul> <p>Syllabuset e lëndëve janë të hartuara qartë dhe të harmonizuara në funksion të njohurive me të cilat programi synon të formojë studentët.</p> <p>[Dok DVV Aneks 10. Syllabuse MRK; Aneks 14. Syllabus Praktike Laboratorike 1; Aneks 14.1. Syllabus Praktike Laboratorike 2]</p>   |                             |  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p> | <p>Universiteti POLIS e ka organizuar programin e studimit MRK që t'ju ofrojë studentëve të tij fleksibilitet dhe të lejojë edhe angazhimin e studentëve në punë. Mësimi i këtij programi studimi zhvillohet në fundjavë. Gjithashtu programi organizohet duke ofruar vetëm një lëndë në një periudhë kohore, duke i marrë lëndët njëra pas tjetrës. Kjo i ndihmon studentët të jenë të përqëndruar dhe t'i japin përparësi vetëm një lëndë në kohë.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion studentët u shprehën se ishin krijuar kushtet për ndjekjen e programit edhe kur studentët ishin në punë.</p> <p>[Vizita në Institucion: Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS]</p>  |                             |  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>  | <p>Në programin e studimit MRK praktika zë një vend të rëndësishëm. Bazuar në planin mësimor të programit MRK, i përditësuar për të qënë konform VKM Nr.879, datë 18.12.2019, dedikuar komponentëve praktikë në auditor (laboratorë, praktikë profesionale) janë <b>572</b> orë mësimore, dhe përkundrejt <b>1086</b> orëve në auditor në total, që ka plani mësimor, rezulton se <b>53%</b> e orëve janë orë të punës praktike të studentëve.</p> <p>Përveç peshës së përshtatshme që zë praktika në programin mësimor, Fakulteti i Kërkimit dhe Zhvillimit zhvillon periodikisht takime me kompanitë apo leksione të hapura, për të sjellë një panoramë më të qartë të asaj që kërkon tregu i punës. Ndër to mund të përmendim “Siguria e Informacionit ne shekullin XXI” e organizuar nga eksperti i sigurise se informacionit Daniel Bohannon, leksioni i hapur “Hyrje ne teknologjinë Cisco DMVPN” nga eksperti i rrjeteve kompjuterike Teodor Boshku, leksion i hapur nga Luca Lezzerini, etj.</p> <p>[DVV Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar]<br/> <a href="https://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/2524">https://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/2524</a><br/> <a href="https://es-la.facebook.com/polisuniversity/posts/2734963009904863/">https://es-la.facebook.com/polisuniversity/posts/2734963009904863/</a><br/> <a href="https://www.facebook.com/polisuniversity/posts/2976891742378654">https://www.facebook.com/polisuniversity/posts/2976891742378654</a></p> |                             |  |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p>Përmbushet pjesërisht</p>   | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p> |

**Standardi II.2**

**Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxëniet sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.**

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 [04] 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 12

| Kriteret   | Vlerësimi   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënës dhe punësimin e studentëve.</p> | <p>Programi studimit MRK ofrohet në gjuhën shqipe, me 120 kredite (ECTS), në 2 vite akademike, 4 (katër) semestra. Sipas rregullores së programit një krediti të formimit i korrespondon 25 orë mësimore punë të studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, etj.) dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të tij.</p> <p>Veprimtaria akademike e këtij programi ka filluar në vitin akademik 2019-2020. Për studentët e atij viti akademik veprimtaritë formuese kanë qenë të grupuara në disiplina si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm 21 kredite (17.5%);</li> <li>- Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues të programit të studimit 48 kredite (40%);</li> <li>- Veprimtari në disiplina të formimit të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterisuese 12 kredite (10%);</li> <li>- Veprimtari në disiplina të formimit plotësuese si, praktika apo stazhe 24 kredite (20%);</li> <li>- Përgatitja e projektit/punës finale 15 kredite (12.5%).</li> </ul> <p>Për të qenë në përputhje me VKM Nr.879, datë 18.12.2019 veprimtaritë formuese u grupuan në disiplina si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) 18 kredite (15%);</li> <li>- Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues të programit të studimit 66 kredite (55%);</li> <li>- Veprimtari në disiplina të formimit të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterisuese 18 kredite (15%);</li> <li>- Veprimtari në disiplina të formimit plotësuese si, praktika apo stazhe 12 kredite (10%);</li> <li>- Përgatitja e projektit/punës finale 6 kredite (5%).</li> </ul> <p>Studentët e viti akademik 2020-2021 ndjekin planin mësimor me këto ndryshime. Këto elementë bëjnë të mundur arritjen e objektivave formuese të programit të studimit, e gjithashtu të rezultateve të pritshme të të nxënës dhe punësimin të studentëve pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Nga tabela e ndryshimeve gjykojmë se ndryshimet për shkak të pershtatjes me aktet ligjore janë më shumë se 20%. GVJ nuk i gjeti Vendimin e Senatit Akademik të Polis dhe miratimin nga MASR për këto ndryshime në Dosjen DVV.</p> <p>[Dok DVV Aneks 8. Rregullore Programit të Studimit (e vjeter); Aneks 9. Plani Mësimor (Matrica) ekzistuese; Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar); Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar]</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktivitetëve formuese janë informuese dhe</p>   | <p>Plani mësimor i programit të studimit MRK dhe syllabuset e lëndëve janë të plota dhe informuese. Ata përmbajnë të gjitha elementet konform VKM Nr.879, datë 18.12.2019. Plani mësimor ka të detajuar çdo informacion për lëndët, grupimin e tyre sipas tipeve të veprimtarive (A, B, C, D E) dhe peshën për</p>  |

|   |  |                             |                                       |
|---|--|-----------------------------|---------------------------------------|
| i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.   | secilën kategori, organizimin e lëndëve (leksione, seminare, laboratorë etj), peshën e krediteve dhe orëve për to etj. Gjithashtu, të gjitha syllabuset përmbajnë elementet e kërkuar në VKM Nr. 41, DATË 24.1.2018 (ndryshuar me VKM Nr. 879 datë 18.12.2019), si edhe janë sipas modelit të syllabusit që kjo VKM paraqet në shtojcën nr. 3 të saj.<br><br>[Dok DVV Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar); Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar]   |                             |                                       |
| <b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësisimit në praktikë/punë konkrete në profesion.   | Në programin e studimit MRK orët totale në auditor (1086 orë) ndahen në orë dedikuar për leksione, ushtrime dhe seminare, 47%, si dhe laboratorë dhe praktika lëndore, 53%. Gjithashtu pesha e veprimtarive dedikuar aftësisimit praktik është 25 % e peshës totale të programit. Konkretisht:<br><br><ul style="list-style-type: none"> <li>• Internship: 12 kredite (10%)</li> <li>• Praktikë Laboratorike (1, 2): 12 kredite (10%)</li> <li>• Projekti final: 6 kredite (5%)</li> </ul> [Dok DVV Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar]   |                             |                                       |
| <b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Formimi teori/praktikë, në programin e studimit MRK, ka një raport të duhur në mënyrë që studentët të marrin të gjitha njohuritë teorike të ndërthurura me ato praktike dhe mundëson arritjen e transmetimit dhe përvetësimin të dijeve që tregu i punës kërkon nga studenti pas përfundimit të studimeve. Gjatë vizitës studentët u shprehën se i kishin njohuritë e nevojshme për t'u integruar në ambientin e punës madje në disa fusha tejkalonin pritshmëritë e tyre.<br><br>Universiteti Polis orienton studentët e programit të studimit MRK drejt certifikimeve të ndryshme në fushën e IT & Rrjetit. Së fundmi, Universiteti Polis në bashkëpunim me EIPASS ofron për studentët e këtij program studimi, certifikatën profesionale EIPASS 7 MODULI, e njohur si Pasaporta Europiane e Informatikës.<br><br>[Dok DVV Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar; Dokumenta të marra gjatë vizitës: 4. Marrëveshja me EIPASS; Shenimet në vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS] |                             |                                       |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b>   | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b><br><br>X |

### Standardi II.3

**Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe**

| Kriteret   | Vlerësimi   |
|--|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit. | Programi i studimit MRK përmban të dhëna të plota lidhur me përmbajtjen teorike e praktike të lëndëve. Gjatë vizitës në institucion studentët u shprehën se në lidhje me projektin final dhe internshpet marrin të gjithë mbështetjen e nevojshme nga pedagogët. Universiteti POLIS, nëpërmjet faqes së tij zyrtare të internetit apo rrjeteve sociale, jep informacione ku përfshihen dhe aktivitete formimi për studentët si takime me kompanitë/leksione të hapura, që sjellin një panoramë më të qartë të asaj që kërkon tregu i punës. |

|  |   |
|--|---|
|  | [Dok DVV Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar; Aneks 10. Syllabuse MRK; Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS;]  |
| <b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.  | Bazuar në planin mësimor të programit të studimit MRK dhe syllabuseve të lëndëve përmbajtja e tij është aktuale. Universitetit Polis ka marrë mendime nga tregu i punës në lidhje me kurrikulën e programit të studimit MRK. Sipas mendimit të tyre kjo kurrikulë është e përshtatshme nga ana e formimit teorik/praktik për një specialist rrjeti. Gjithashtu sipas RVB, në shtator 2020 është zhvilluar një webinar me kompani te ndryshme, si Abissnet, Infosoft, Albtelekom, CSP, etj që shprehën mendimet e tyre, si edhe sugjerimet lidhur me kurrikulën e programit të studimit MRK, duke e konsideruar atë ne përputhje me kërkesat e punëdhënësve.<br><br>DVV Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar; Aneks 10. Syllabuse MRK; Aneks 23. Mendime_tregu i punes]   |
| <b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.  | Referuar Rregullores së programit te studimit MRK, (neni 8 Transferimi i studimeve në të njëjtin program studimi) dhe Rregullores didaktike, Universiteti Polis pranon transferime nga institucione të tjera të arsimit të lartë. Njëkohësisht ky Universitet lejon edhe transferimin e studentëve të tij në programe të ngjashme me karakter profesional. Studentët e Universitetit Polis kanë të drejtë të kërkojnë transferimin e krediteve të marra për lëndë të njëjta ose të ngjashme të cilat i kanë marrë në institucione të tjera për programe të caktuara studimi. Njohja e lëndëve dhe vlerësimi i krediteve, bëhet nga një komision i veçantë i ngritur për këtë qëllim. Bazuar në syllabuset e programit të studimit MRK, përmbajtja e moduleve/lëndëve dhe metodat e vlerësimit të tyre e mbështetin transferimin e aftësive. Metodot e teknikat e mësimdhënies të përdorura (raste studimi, përdorimi i simulatorëve etj) janë të përshtatshme për përvetësimin e njohurive të përcaktuara në module.<br><br>[DVV Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar; Aneks 20. Rregullore Didaktike] |
| <b>Kriteri 4.</b> Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim të njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvijën e punës. | Lëndët e formimit teorik janë hartuar në mënyrë të tillë që studentët të kenë mundësinë të përfitojnë njohuritë e duhura, mendimin kritik dhe aftësitë praktike. Përfshirja në Program e disa lëndëve specifike si ‘Sipërmarrja dhe Biznesi’ apo ‘Shkrim akademik’ shërbejnë si një ndër elementët më të rëndësishëm, të cilat para përgatisin studentët për t’u përballur me situata të ndryshme duke fituarë aftësi ndërkurrikulare si komunikimi dhe marrëdhëniet me të tjerë, etj.<br><br>[DVV Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar; Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS;]   |
| <b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me  | Universiteti POLIS ka realizuar disa marrëveshje bashkëpunimi me punëdhënës, partnerë nga tregu i punës. Nga këto marrëveshje studentët do të përfitojnë zhvillimin e praktikave/internshipeve, si edhe mundësi punësimi pas përfundimit të internshipit. Internshipi për studentët aktual të programit profesional Mirembajtje Rrjete Kompjuterike është realizuar me kompaninë CSP (Communication Security Powerhouse). Sipas RVB, në përfundim të këtij internship studentët plotësuan një pyetësor, prej të cilëve rezultoi se 98% e studentëve vlerësuan maksimalisht (me 5) internshipin lidhur me organizimin,   |

|  |   |                             |                              |   |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|---|
| kërkesat e profesionit.                                  | përgatitjen e stafit të inxhinierëve të kompanisë, temat e trajtuara, etj. Si njohuritë, e marra gjatë vitit akademik edhe përfshirja e studentëve në aktivitete me subjekte të ndryshme, ndihmon ata të përballen me tregun e punës gjatë periudhës së studimeve. Ky proces favorizon punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve.<br><br>[DVV Aneks 6. Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit; Aneks 11. Kalendar i Praktikave 2019-2020; Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar; Aneks 25. Aktivitete konferenca online] |                             |                              |   |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>               | <b>Përmbushet pjesërisht</b>  | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |   |
|  |   |                             |                              | X |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b>  | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |   |
|  |   |                             |                              | X |

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës

| Kriteret  | Vlerësimi  |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike. | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon aktivitetin e monitorimit në Universitetin POLIS, i cili në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme, përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj. NJBSC është struktura e posaçme që zhvillon mekanizmat e vlerësimit dhe të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies në Universitetin Polis. Kjo strukturë, monitoron dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies periodikisht përmes pyetësorëve të studentëve dhe të stafit. Pas shpërndarjes analizimit të pyetësorëve hartohet një raport nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezultatet e të cilit i bëhen me dije strukturave përkatëse pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve.<br><br>Sipas RVB, rezultatet finale të përfituara prej pyetësorëve bëhen publike, duke ja komunikuar stafit, studentëve, administratës si dhe më gjerë, në mbledhjet e hapura të Senatit Akademik. Raportet vjetore të NJBSC dërgohen në MASR dhe ASCAL.<br><br><a href="https://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1627">https://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1627</a><br><br>[DVV Aneks 19. Vlerësim nga studenti për pedagogun; Aneks 19.1 Vlerësimi i kolegut për kolegun; Aneks 19.1 Vlerësimi i kolegut për kolegun; Aneks 18. Raporti Vjetor i NJBSC (2019-2020)] |
| <b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e   | Sipas rregullores didaktike format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive të përdorura në Universitetin Polis janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike dhe studio, konsultimet, prezantimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, ese,  |



|  |   |
|--|---|
| <p>kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>  | <p>punime e kërkime shkencore eksperimentale në fushat përkatëse etj.</p> <p>GVJ konstaton, bazuar në planin mësimor të programit të studimit MRK (*), se këto janë format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive që janë përdorur për këtë program janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksionet - 300 orë mësimore në auditor</li> <li>• Seminaret - 190 orë mësimore në auditor</li> <li>• Laboratorët - 432 orë mësimore në auditor</li> <li>• Ushtrimet/Detyrat - 24 orë mësimore në auditor</li> <li>• Praktikrat - 140 orë në auditor</li> </ul> <p><i>(*) Sipas Tabeles 13 në dok 2: Tabela përmbledhese MRK rezultojnë këto shifra: Leksione: 252 orë / Seminaret: 178 orë / Ushtrime/Laboratorë: 376 orë / Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale (Praktikat Laboratorike): 132 orë /Projekti Final: 88 orë.</i></p> <p>Janë organizuar gjithashtu orë leksioni të hapura të cilat janë përmendur në standardin II.1, kriteri 6.</p> <p>[DVV Aneks 20. Rregullore Didaktike, Kreu 5, Neni 20: Format e mësimi; Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar]</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p> | <p>Gjatë takimit me pedagogët dhe studentët e programit të studimit MRK, GVJ mori informacion mbi mënyrën e zhvillimit të mësimdhënies e mësimnxënies. Pedagogët punojnë me qëllim përshtatjen e dijeve për interes të grupit ku ata japin mësim, si dhe përshtasin dijen e tyre me nevojat për njohuri të grupit. Pedagogët e përfshirë në mësimdhënie janë të specializuar në fushat ku ata japin leksion, gjë e cila i bën ata kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Për qëllime të realizimit të orëve mësimore dhe të shpërndarjes së dijeve, pedagogët përdorin metoda interaktive dhe gjithëpërfshirëse.</p> <p>Në orët në auditor synohet trajtimi i situatave konkrete nga përvoja e profileve përkatëse, sjellja e shembujve konkrete dhe simulohen situata reale. Psh, në lëndën Bazat e Rrjeteve Kompjuterike, përdoren simulatorët e rrjetit për të ndërtuar rrjete virtuale; për të simuluar bashkëveprimet e të dhënave që udhëtojnë përmes një rrjeti; për të vizualizuar rrjetin si në mënyrën logjike ashtu edhe në atë fizike;</p> <p>Bashkëpunimi me sektorin privat përfshin edhe shkëmbimin e përvojave në nivel kapacitetesh njerëzore. Sipas RVB, universiteti ofron trajnim shtesë si dhe laboratore apo ambiente shtesë për stafin e kompanive. Kompanitë sjellin staf të specializuar dhe me mjaft përvojë për të realizuar trajnime apo prezantime për stafin dhe studentët.</p> <p>[Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS; Dok DVV Emër Mbiemër_CV; RVB], [Doc. Tabela përmbledhëse]</p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>  | <p>Për t'u ardhur në ndihmë pedagogëve të rinj, Universiteti Polis mundëson ndjekjen e leksioneve të dhëna nga stafi akademik më me përvojë në mësimdhënie. Institucioni mundëson pjesëmarrjen e stafit në projekte të ndryshme si projektet Erasmus+, p.sh në kuadër të projektit Erasmus + CBHE: "Developing Research and Innovation Capacities in Albania and Kosovo" / DRIVE" u zhvillua në Universitetin e Gjakovës në datat 21-24 shtator trajnimi për Metodologjitë e Mësimdhënies nga partnerët e projektit, i cili ka partnerë europianë Universitetin Aalborg, Universitetin Politeknik të Mynihut dhe</p>  |

|  |  |                             |                              |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
|  | <p>Universitetin Politeknik të Milanos. Sipas RVB, pjesëmarrëse në trajnim ishte koordinatori e programit MRK, e cila pas trajnimit përcolli eksperiencën e saj tek stafi akademik i angazhuar në program.</p> <p><a href="https://universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/2542">https://universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/2542</a>. <a href="https://uni-gjk.org/en/lajme/1280/um-bajt-punetoria-trajnuese-per-metodologjite-e-mesimdhënies">https://uni-gjk.org/en/lajme/1280/um-bajt-punetoria-trajnuese-per-metodologjite-e-mesimdhënies</a></p> |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b>   | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                             | X                            |

### Standardi III.2

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor**

| Kriteret  | Vlerësimi   |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>   | <p>Në vizitën e zhvilluar në ambjentet e Universitetit Polis, GVJ konfirmon se veprimtaria akademike ushtrohet në një mjedis me hapësira të mjaftueshme, cilësore dhe funksionale ku përfshihet logjistika e nevojshme për realizimin cilësor të procesit mësimor. Mjediset mësimore dhe hapësirat ndihmëse janë të pastra, të ndriçuara e të ajrosura mjaft mire. Ambjentet janë të pajisura me sistemin e ngrohjes e ftohjes, me video projektorë dhe kanë bazën e nevojshme didaktike për zhvillimin normal të procesit mësimor. Hapësira dhe infrastruktura e Universitetit Polis janë të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit MRK. Ky program disponon edhe laboratorin e dedikuar, në kompjuterat e të cilit janë instaluar të gjitha programet software të nevojshme për orët laboratorike të çdo lënde si simulatorët Wireshark, Packet Tracer, etj. Laboratori i ICT ka edhe një ambient të dedikuar për pajisjet hardware si pajisjet e rrjetit (routera, switche, hube, etj), mjediset e transmetimit (adsl, fiber, coax etj), koka rrjeti, konektorë, kabuj, etj. Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik i programit u shpreh se çdo kërkesë e tyre në lidhje me bazën materiale për procesin mësimor është përmbushur nga universiteti Polis.</p> <p>[Aneks 20. Siperfaqet POLIS; Vizita në institucion; Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS]</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p> | <p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se në funksion të cilësisë së mësimdhënies së programit të studimit MRK Universiteti Polis ka aktualisht 2 laboratorë, njëri i dedikuar për këtë program. Një tjetër laborator, në funksion të cilësisë së mësimdhënies edhe të programit të studimit MRK, është duke u ndërtuar. Laboratorët kanë pajisjet e duhura harduerike dhe softuerike që studentëve ju nevojiten. Universiteti Polis disponon një infrastrukturë të konsoliduar IT. Sipas RVB, gjatë pandemisë zyra e IT ka ndihmuar dhe trajnuar stafin apo studentet lidhur me platformat online të mësimdhënies si Google Classroom, Google Meet, Zoom, etj. Praktika për lëndën Praktikë Laboratorike, e asistuar nga pedagogu A. Sula i cili ka qënë pjesë e zyrës IT të Universitetit Polis, mbështetet nga zyra e IT dhe ka si qëllim që studentët të kuptojnë rrjetin e Universitetit, të njihen me datacenterin dhe pajisjet që mirembahen vazhdimisht nga zyra e IT, konfigurimet e brendshme, etj. Universiteti POLIS ka sistemin elektronik të komunikimit të brendshëm për stafin dhe studentët. Sipas RVB, stafi përdor sistemin ESSE3 për hedhjen e notave dhe vlerësimeve të vazhduara</p>  |

|  |   |
|--|---|
|  | <p>gjatë vitit.</p> <p>[Vizita në Institucion: Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS; dok DVV Aneks 11. Kalendari i Praktikave 2019-2020; Emer Mbiemer_CV;  [Aneks 26 Sistemi ESSE3]</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p> | <p>Program i studimit MRK ofrohet në gjuhën shqipe. Sipas rregullores didaktike të Universitetit Polis pedagogët, për të realizuar procesin e mësimdhënies, duhet të përgatisin materialin e mëposhtëm: a. programin e detajuar të lëndës apo syllabuset; b. materialet për studimin e lëndës. Gjatë vizitës në institucion studentët u shprehën se marrin informacion të plotë për lëndën që në fillim të vitit akademik, literatura u dërgohet elektronikisht në Google Classroom, ku kanë realizuar mësimin online, dhe se literatura është e mjaftueshme. Sipas RVB, materialet e studimit, duhet të organizohen nga pedagogu në formën e një dispense dhe të dorëzohen në Kancelari përpara fillimit të vitit akademik.</p> <p>[Aneks 20. Rregullore Didaktike Kapitullin VI, Neni 25 &amp; 28; Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS]</p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>   | <p>Universiteti POLIS është i abonuar në bibliotekën dixhitale JSTOR. Sipas RVB, në bibliotekën JSTOR, Universiteti POLIS është abonuar në tre volume të Arts &amp; Science Volumes dhe në koleksionin e Qëndrueshmërisë, koleksione që përmbajnë gjithsej 600 revista. EBSCOhost është një tjetër bibliotekë dixhitale që POLIS i ofron mundësi studentëve për t'a aksesuar. Universiteti Polis, në sajë të marrëveshjes me EIPASS që e bën Universitetin Polis qendër EIPASS, ofron literaturë online në gjuhën Shqipe dhe Angleze.</p> <p><a href="https://www.ebsco.com/">https://www.ebsco.com/</a> <a href="https://www.jstor.org/">https://www.jstor.org/</a></p> <p>[Dok gjatë vizitës në institucion 4. Marrëveshja me EIPASS]</p>   |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>   | <p>Infrastruktura e nevojshme laboratorike për programin e studimit MRK është e plotësuar në sasi të nevojshme dhe sipas kërkesave të tij specifike. Ajo krijon mundësinë e realizimit në kushte optimale të detyrave të programit, detyra kursi apo studime specifike të karakterit profesional. E gjithë infrastruktura është e gatshme, në funksion, plotësisht funksionale dhe që shfrytëzohet pa asnjë pengesë nga studentët e këtij programi studimi. Duke qënë se semestri i dytë i vitit akademik 2019-2020 ishte online, sipas RVB, në mënyrë që të rikuperoheshin orët praktike të pamundura të realizoheshin në kushtet e pandemisë, gjatë periudhës së verës 2020, laboratori u vu në dispozicion të stafit dhe studentëve sipas një grafiku. (linku në RVB) Kjo me qëllim realizimin e praktikave të çdo lënde të zhvilluar online.</p> <p>[Vizita në Institucion: Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS]; [<a href="https://universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/2569">https://universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/2569</a>]</p> |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>   | <p>Në funksion të procesit mësimor dhe të edukimit profesional, personeli akademik dhe studentët e programit të studimit MRK përdorin platforma on-line (elearning). Sipas RVB, gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 platforma si Zoom, Skype, Google Classroom, Microsoft Teams, etj ishin më të përdorurat nga stafi dhe studentët. Për të gjitha lëndët, ruajtja dhe dokumentimi i materialeve gjatë procesit online u realizua përmes Google Classroom. Kjo u konfirmua dhe nga studentët gjatë vizitës në institucion. Gjatë takimit me stafin akademik u vu re dhe përdorimi i platformës Coursera kryesisht për t'u njohur me kurse të ofruara nga universitete të tjera në të njëjtën</p>   |

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 [04] 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 19

|                                     |  |                      |                       |   |
|-------------------------------------|--|----------------------|-----------------------|---|
|                                     | fushë. [Vizita në Institucion: Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS]; |                      |                       |   |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht  | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |   |
|                                     |  |                      |                       | X |

### Standardi III.3

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre**

| Kriteret  | Vlerësimi   |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p> | <p>Universiteti POLIS ka ngritur struktura në nivel institucional për të promovuar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), njësia e përhershme e pavarur, permanente, ka konsoliduar mënyrën e kontrollimit dhe përmirësimit të cilësisë në Universitetin POLIS. Gjatë vizitës në institucion NJBSC u shpreh se vlerësimi i mësimdhënies, proces që monitorohet dhe koordinohet nga kjo njësi, fillon me pyetësorët që plotësojnë studentët të cilët japin mendimin e tyre për çdo lëndë dhe dhe administratën IT, bibliotekë, sekretari etj.</p> <p>Personeli akademik bën vetëvlerësim dhe vlerësohet gjithashtu nga kolegët. Me të dhënat që nxjerr NJBSC krijon një raport të cilin e prezanton në rektorat e dekanateve të fakulteteve dhe më pas i bëhen të ditura secilit staf personalisht. Ky raport paraqitet më pas në mbledhjen e hapur të senatit.</p> <p>[Vizita në Institucion: Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS]; [DVV Aneks 19. Vleresim nga studenti per pedagogun]; [Aneks 19.1 Vleresimi i kolegut per kolegun]; [Aneks 19.3 Vetevleresim i performances se lektorit]; [Aneks 18. Raporti Vjetor i NJBSC (2019-2020)]<br/>[<a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1627">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1627</a>]</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>  | <p>Program i studimit MRK zhvillohet në njësinë bazë Departamenti i Kërkimit të Aplikuar dhe njësinë kryesore Fakulteti i Kërkimit dhe Zhvillimit. Bazuar në kapitullin II, Neni 8, të Rregullores së përgjithshme, departamenti është përgjegjës për ngritjen dhe hartimin e programeve të studimit edhe nxitjen, programimin, bashkërendimin, zhvillimin, organizimin dhe administrimin e veprimtarisë së mësimdhënies. Procesi i mesimdhënies është subjekt i monitorimit të vazhdueshëm dhe raporti që NJBSC krijon shërben si indikator i vlerësimit për drejtuesit e departamenteve.</p> <p>[DVV Aneks 4. Rregullore e Pergjithshme; Vizita në Institucion: Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS; Aneks 18. Raporti Vjetor i NJBSC (2019-2020)]</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve</p>   | <p>Bazuar në rregulloren didaktike stafi ka liri akademike për të hartuar syllabuset në përputhje me objektivat kurrikulare (Kreu VI Rregulla për procesin mësimor dhe përgatitjen e materialeve informative neni 25 materiali për mësimdhënie) dhe është përgjegjës për procesin mësimor (Neni 29 Organizimi i proçesit mësimor nga pedagogu) Për të garantuar cilësinë e mësimdhënies, personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MRK përdor mjete dhe teknika të ndryshme, si p.sh simulatorët e rrjetit, rastet e studimit, vizita në terren etj.</p> <p>[Dok DVV Aneks 20. Rregullore Didaktike; Aneks 11. Kalendar i Praktikave</p>   |

|  |  |                             |                            |                             |
|--|--|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| profesionale.  | 2019-2020; Vizita në Institucion: Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS;   |                             |                            |                             |
| <b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre. | <p>Pjesë e misionit të Universitetit POLIS është të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe të aplikuar si dhe inovacionit. Universiteti Polis angazhohet në përmirësimin e teknikave të mësimdhënies. Ai është koordinatori i projektit Erasmus + CBHE: Drive që siç u përmend në standardin III.1 kriteri 5 zhvilloi në Universitetin e Gjakovës në datat 21-24 shtator trajnimin për Metodologjitë e Mësimdhënies nga partnerët e projektit dhe pjesëmarrëse në trajnim ishte koordinatorja e programit MRK, e cila pas trajnimit përçolli eksperiencën e saj tek stafi akademik i angazhuar në program. Bazuar në raportin e NJBSC dhe RVB mësimdhënja në programin e studimit MRK është zhvilluar me korrektësi dhe në mënyrë cilësore duke u vlerësuar shumë pozitivisht si nga studentët ashtu dhe fakulteti.</p> <p>[DVV Aneks 4. Rregullore e Përgjithshme; Aneks 18. Raporti Vjetor i NJBSC (2019-2020)]<br/> <a href="https://universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/2542">https://universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/2542</a><br/> <a href="https://uni-gjk.org/en/lajme/1280/u-mbajt-punetoria-trajnuese-per-metodologji-te-e-mesimdhenies">https://uni-gjk.org/en/lajme/1280/u-mbajt-punetoria-trajnuese-per-metodologji-te-e-mesimdhenies</a><br/> <a href="https://driveproject-eu.com/2020/03/31/wp-2/">https://driveproject-eu.com/2020/03/31/wp-2/</a></p> |                             |                            |                             |
| <b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.                                     | <p>Bazuar në rregulloren didaktike departamentet, me miratim të Dekanatit, mund të përcaktojnë edhe forma të tjera të punës mësimore, veçanërisht të kontrollit të dijeve të fituara. Përcaktimi i formave të reja bëhet para fillimit të vitit të ri akademik dhe i bëhet i ditur studentit në fillim të procesit mësimor. Viti akademik 2020-2021 kishte domosdoshmëri përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie. FKZH miratoi forma të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimdhënies online, i analizoi ato dhe krijoi raportin: A Critical Reflection On The Distant And Close Teaching, And Learning Practices In The Context Covid-19 Pandemic. Metodat e përdorura nga stafi akademik i programit të studimit MRK u mirëpritën nga studentët gjithashtu.</p> <p>[DVV Aneks 4. Rregullore e Përgjithshme; Aneks 18. Raporti Vjetor i NJBSC (2019-2020); Vizita në institucion; </p> <p><a href="http://www.universitetipolis.edu.al/sites/default/files/Reflection/teaching_during_Covid-19_times.pdf">http://www.universitetipolis.edu.al/sites/default/files/Reflection/teaching_during Covid-19 times.pdf</a></p>  |                             |                            |                             |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Përmbyhet</b>   | <b>Përmbyhet pjesërisht</b> | <b>Përmbyhet kryesisht</b> | <b>Përmbyhet plotësisht</b> |
|  |  |                             |                            | X                           |

#### Standardi III.4

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.**

| Kriteret  | Vlerësimi  |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimentet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e | Rregullorja didaktike e Universitetit Polis përcakton komponentet e tabelës së vlerësimit të studentëve (neni 30), kriteret pengues (neni 31), procesverbalin e vlerësimit: përmbyajtjen, ruajtjen, dokumentimin (neni 32), shpalljen e rezultateve dhe dokumentimin (neni 33). Ky dokument publikohet në faqen zyrtare të universitetit. Në çdo syllabus paraqiten komponentët e vlerësimit të lëndëve, dhe pesha e tyre. Syllabuset u bëhen të njohur studentëve në orën e parë të çdo lënde. Në rregulloren didaktike përcaktohet gjithashtu se në përfundim të semestrit pedagogu dorëzon në Sekretarinë Mësimore: proces- |

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 [04] 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 21

| <p>procedurave në rregulloret përkatëse.</p>  | <p>verbalin e vlerësimit së bashku me Tabelën e Detajuar të Vlerësimeve, e cila përmban të gjitha elementet që janë paraqitur në syllabus dhe detyrat e kryera nga studentët si në hardcopy ashtu dhe në format elektronik. Studenti ka të drejtë të ankimojë rezultatin, procedura dhe afatet e të cilit janë përcaktuar në rregulloren didaktike.</p> <p>[DVV Aneks 20. Rregullore Didaktike]<br/> <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/sites/default/files/pdf/Rregullore%20Didaktike.pdf">http://www.universitetipolis.edu.al/sites/default/files/pdf/Rregullore Didaktike.pdf</a></p>  |                                  |           |   |     |   |     |                      |     |                 |             |
|---|---|----------------------------------|-----------|---|-----|---|-----|----------------------|-----|-----------------|-------------|
| <p><b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>   | <p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale, në programin e studimit MRK, përftohet nga mbledhja e pikëve të ndara përgjatë semestrit dhe pikëve të provimit final. Bazuar në tabelën 15 Format e kontrollit të njohurive të dokumentit tabelat përmbledhëse, vlerësimi realizohet nga disa komponentë si më poshtë, duke u dhënë kështu mundësi studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre:</p> <table border="1" data-bbox="614 698 1343 875"> <thead> <tr> <th>Format e kontrollit të njohurive</th> <th>përqindja</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, det. të kursit)</td> <td>30%</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>60%</td> </tr> <tr> <td><b>Në total</b></td> <td><b>100%</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>[DVV Aneks 20. Rregullore Didaktike; Aneks 41. Tabelat përmbledhëse _ASCAL MRK]</p> | Format e kontrollit të njohurive | përqindja | Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive | 10% | Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, det. të kursit) | 30% | Provimi përfundimtar | 60% | <b>Në total</b> | <b>100%</b> |
| Format e kontrollit të njohurive  | përqindja   |                                  |           |   |     |   |     |                      |     |                 |             |
| Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive   | 10%   |                                  |           |   |     |   |     |                      |     |                 |             |
| Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, det. të kursit)   | 30%   |                                  |           |   |     |   |     |                      |     |                 |             |
| Provimi përfundimtar  | 60%   |                                  |           |   |     |   |     |                      |     |                 |             |
| <b>Në total</b>   | <b>100%</b>   |                                  |           |   |     |   |     |                      |     |                 |             |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>                                 | <p>Bazuar në rregulloren didaktike pedagogu sqaron në klasë të gjithë elementet e syllabus-it, përfshirë përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit; konceptet themelore (konceptet mbi të cilat ndërtohet lënda); temat e lëndës, format e kontrollit të dijes, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm; literatura (literature bazë e detyrueshme dhe literature e rekomanduar), ditën e parë të mësimin në fillim të çdo semestri. Studentët, gjatë vizitës në institucion konfirmuan se merrnin informacion mbi syllabusin e lëndës në fillim të semestrit.</p> <p>[DVV Aneks 20. Rregullore Didaktike; Vizita në Institucion: Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike _POLIS;]</p>   |                                  |           |   |     |   |     |                      |     |                 |             |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p> | <p>Sipas RVB, personeli akademik përdor sistemin ESSE3 për hedhjen e notave dhe vlerësimeve të vazhduara gjatë vitit. Rezultatet e vlerësimit, së bashku me komponentët e tij, reflektohen në sistemin online dhe bëhen të dukshme për studentët. Secili student mund të shohë vlerësimin e vet, duke ruajtur anonimat e studentëve. Detyrat e kursit dorëzohen në sekretari nga pedagogu dhe arkivohen.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion studentët deklaruan se provimet online u zhvilluan me anë të platformës Google Classroom me kamera hapur.</p> <p>[DVV Aneks 20. Rregullore Didaktike; Vizita në Institucion: Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike _POLIS;]</p>  |                                  |           |   |     |   |     |                      |     |                 |             |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të</p>  | <p>Bazuar në rregulloren didaktike, për vlerësimin e një lënde ngrihet një komision vlerësimi. Gjithashtu bazuar në këtë rregullore pedagogët, në rast paqartësish, mund t'i japin sqarime studenteve në seanca të posaçme. Sipas RVB, punët laboratorike dhe detyrat prezantohen përpara komisionit dhe në përfundim të procesit të vlerësimit, studentëve në mënyre individuale, iu komunikohen pikat e forta në atë lëndë, si edhe vihen në pah pikat e dobëta,</p>  |                                  |           |   |     |   |     |                      |     |                 |             |

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| ardhmen.   | duke iu dhene sugjerimet përkatëse për t'i ndihmuar në permirësimin e mëtejshëm të tyre. [DVV Aneks 20. Rregullore Didaktike]  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore. | Bazuar në rregulloren didaktike të Universitetit Polis, koha për shpalljen e rezultateve është tre ditë mbas dhënies së provimit. Vonesa në dhënien e rezultatit të vlerësimit, nëse kjo nuk është e motivuar, ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit. Pedagogët, në rast paqartësish, mund t'i japin sqarime studenteve në seanca të posaçme. Studenti ka të drejtë të kontestojë vlerësimin e marrë. Gjatë vizitës në institucion studentët u shprehën se provimet online, të cilët u zhvilluan me Google Classroom, ishin me kamera hapur dhe monitorohej pandershmëria akademike (kopjimi).<br><br>[DVV Aneks 20. Rregullore Didaktike; Vizita në Institucion: Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS;] |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | X                            |

### Standardi III.5

**Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.**

| Kriteret  | Vlerësimi  |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional. | Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë bazë, lëndë karakterizuese dhe plotësuese, nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të mirëmbajtjes së rrjeteve kompjuterike. Bazuar në rregulloren mësimore të tij programi profesional që propozon programi ka për qëllim edukimin dhe trajnimin cilësor të studentëve të cilët kërkojnë të specializohen në zhvillimin e njohurive në mirëmbajtjen e rrjeteve kompjuterike. Programi në tërësi synon përgatitjen teknike profesionale të studentëve mirëmbajtjen e rrjeteve kompjuterike si dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me networkun.<br><br>GVJ konstaton se në përbërje të programit të studimit MRK ka lëndë si Bazat e Rrjeteve Kompjuterike, Analiza dhe Konfigurime, Praktikë Laboratorike 1 & 2, Elektronika Analoge dhe Dixhitale, Siguria Bazë Elektrike, Mirëmbajtje Rrjeti Kompjuterik, etj të cilat, bazuar në syllabuset, garantojnë përfitim e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve në mirëmbajtjen e rrjeteve kompjuterike. Programi është në permirësim e sipër bazuar në feedbackun e marrë nga tregu, punëdhënësit etj. Si rezultat lënda Siguri Rrjeti, i shtohet programit.<br><br>[DVV Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar); Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar; Aneks 10. Syllabuse MRK] |
| <b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit   | Në lëndët e programit të studimit MRK bëhen përpjekje që të krijohen njohuri e shprehi të qëndrueshme për ndërveprimin dhe zgjidhjen e problemeve si ekip nëpërmjet detyrave e kursit/praktikave të zhvilluara në grup.<br><br>Bazuar në RVB, studentëve të programit MRK duke patur parasysh natyrën dinamike të problematikave që rrjeti ofron, gjithmonë iu theksohet rëndësia e  |

|  |   |
|--|---|
| <p>dhe ndërveprimet, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>   | <p>kërkimit online (faqet zyrtare te Cisco, MikroTiK, ZTE, etj) apo forumet me diskutime teknike, ku shumë zgjidhje mund të gjenden atje.</p> <p>[Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar; Aneks 10. Syllabuse MRK; Aneks 11. Kalendari i Praktikave 2019-2020]</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p> | <p>Programi i studimit MRK duke qënë një program profesional, qasja ndaj lëndëve të ndryshme është e tillë që vëmendja më e madhe të peshojë ndaj njohurive praktike. Ka shumë bashkëpunime të vendosura në funksion të realizimit të ketij program studimi.</p> <p>Realizimi i marrëveshjeve me biznesin privat apo institucionet akademike, duke mos pasur kohën dhe kushtet e favorshme gjatë këtyre dy viteve akdemike, ka qënë një sfidë. Universiteti POLIS për studentët e programit MRK, ka zhvilluar me sukses Internshipin per studentet me kompanine CSP.</p> <p>[DVV Aneks 6. Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit; Aneks 11. Kalendari i Praktikave 2019-2020]</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>   | <p>Sipas rregullores didaktike procesi i përgatitjes së syllabuseve (programeve të detajuar) fillon që në vitin akademik paraardhës.</p> <p>Sipas RVB, bazuar në performancën dhe vlerësimin që kanë marrë studentët, pedagogët e angazhuar në programin e studimit MRK, nxjerrin në pah përputhshmërinë e aftësive të fituara nga studentët me qëllim ndryshimet e nevojshme për vitin e ardhshem akademik në syllabusin përkatës.</p> <p>[DVV Aneks 20. Rregullore Didaktike;]</p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>  | <p>Në rregulloren e programit të studimit MRK, percaktohet procedura e diplomimit të studentëve. Bazuar në këtë rregullore studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka përfunduar projektin final, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës, çertifikatën e notave dhe katalogun e përshkrimit të lëndëve. Për programin e studimit MRK janë caktuar dy pedagogë për mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Gjatë takimit studentët u shprehën se një nga pikat e forta të programit është bashkëpunimi pedagog student. Brezi i parë i studentëve të programit të studimit MRK, do të bëhen pjesë e regjistrave zyrtarë të studentëve të diplomuar, pas diplomimit Verë 2021.</p> <p>[Dok DVV Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar); Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar; Vizita në Institucion: Shenimet ne vizite DP Mirembajtje rrjete kompjuterike_POLIS;]</p> |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë</p>   | <p>Bazuar në planin mësimor të programit dy pedagogë efektivë në programin e studimit MRK, mbështesin dhe udhëzojnë studentët në procesin e diplomimit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, takimit me studentët ata u shprehën se gjejnë</p>  |



|   |   |                             |                            |                             |
|---|---|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj. | mbështetje të të dy këta pedagogë dhe se bashkëpunimi pedagog student është një nga pikat e forta të programit. Brezi i parë i studentëve do t'i nënshtrohet procesit të diplomimit në verë 2021. |                             |                            |                             |
|   | [Aneks 13. Plani Mësimor (Matrica) e rishikuar;]  |                             |                            |                             |
| <b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>   | <b>Jo e përbushet</b>   | <b>Përbushet pjesërisht</b> | <b>Përbushet kryesisht</b> | <b>Përbushet plotësisht</b> |
|   |   |                             |                            | X                           |
| <b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</b>  | <b>Jo e përbushet</b>   | <b>Përbushet pjesërisht</b> | <b>Përbushet kryesisht</b> | <b>Përbushet plotësisht</b> |
|   |   |                             |                            | X                           |

#### IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

##### Standardi IV.1

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre**

| Kriteret   | Vlerësimi  |
|--|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij. | <p>Universiteti POLIS ndjek një politikë të qartë në drejtim të rekrutimit të stafit akademik synim i së cilës është tërheqja e stafit të kualifikuar me grada e tituj shkencor, me eksperiencë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik të plotë dhe me kohë të pjesshme janë të përcaktuara në Statut (kreu IX) dhe Rregulloren e Përgjithshme (kreu IV), të U_POLIS Universiteti POLIS ka hartuar dhe është në funksion Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2016-2020 e cila është hartuar bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit (2020-2026). Në procesin e rekrutimit të stafit akademik synohet përthithja e një stafi me eksperiencë. Procesi i rekrutimit bazohet në sistemin e pikëzimit. Eksperiencë në mësimdhënie ka komponentë mënyrën e mesimdhënies dhe arrijtet e paraqitura nga kandidati vlerësohet sipas shkallës Likert (1-5) ndërsa eksperiencë individuale profesionale në punë vlerësohet nga komponenti i aftësive të mësimdhënies, kreativiteti dhe relevanca në fushën shkencore</p> <p>Institucioni dëshmoi nga vizita dhe dokumentacioni që ndjek një praktikë korrekte në lidhje me rekrutimin e stafit akademik. Njoftimi për vendet vakante jepet në website të universitetit: <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/367">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/367</a>.</p> <p>Kërkesa për stafin akademik buron nga planet mësimore që hartohen në kuadrin e njësisë bazë dhe miratohen nga njësi kryesore. Institucioni garanton publikimin e vendeve vakante në faqen zyrtare dhe vë në dijeni Shërbimin Kombëtar të Punës. Institucioni ka të ngritur Zyrën e Burimeve</p> |

|   | <p>Njerëzore e cila menaxhon procesin e rekrutimit ndërsa kriteret specifike vendosen nga njësia bazë. Në lidhje me kriteret specifike kandidati duhet të ketë eksperiencë në fushën e Informatikës, Inxhinieri Telekomunikacioni, Elektronikë dhe një pikë e fortë konsiderohet eksperiencia e punës në kompani IT, mirëmbajtje rrjeti etj Komisioni adhoc i ngritur nga Rektorati realizon procesin e intervistave dhe merr vendimarrjen unanime.</p> <p>[Aneks 29. Procedura e rekrutimit te personelit.pdf], [Aneks 30. Strategjia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore.pdf]. [6. Procedure-Thirrje per punesim.pdf; takim me Drejtorine e Burimeve Njerezore].</p>   |                               |                         |          |                         |  |     |     |     |     |          |   |  |   |  |            |   |  |   |  |               |   |   |   |  |                    |   |   |   |   |     |   |   |   |   |  |          |          |          |          |
|---|---|-------------------------------|-------------------------|----------|-------------------------|--|-----|-----|-----|-----|----------|---|--|---|--|------------|---|--|---|--|---------------|---|---|---|--|--------------------|---|---|---|---|-----|---|---|---|---|--|----------|----------|----------|----------|
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p> | <p>U_POLIS ka në funksion Drejtorinë e Burimeve Njerëzore e cila është përgjegjëse për administrimin e të dhënave personale të stafit akademik dhe administrativ. GVJ bëri edhe një vizitë në Zyren e Burimeve Njerëzore dhe konstatoi se praktika e menaxhimit të të dhënave personale të stafit akademik dhe administrative është në përputhje me aktet e brendshme, Rregulloren e Përgjithshme të Institucionit. Në vizite u verifikuan përmes një përzgjedhje rastësore dosje personale të staf akademik PAE dhe PAK. Njësia bazë monitoron edhe ngarkesat personale mësimore të stafit akademik. Në fillim të vitit akademik njësia baze planifikon ngarkesat mësimore të stafit për programin mesimor. Vëmendje i kushtohet që programi të përballohet përmes angazhimit të stafit PAE. Njësia bazë ka përcaktuar edhe koordinatoren e programit i cili monitoron ecurinë e programit mësimor. Për garantimin e cilësisë së praktikave profesionale përveç punës që zhvillohet nga stafi akademik, njësia bazë ka caktuar edhe një vëzhgues të praktikave të studentëve i cili është përgjegjës për monitorimin e procesit, ndjekjen e ecurisë së studentëve gjatë zhvillimit të praktikave dhe zgjidhjen e problematikave që mund të dalin.</p> <p>[Vizitë në institucion; Aneks 36. Udhëzues për stafin] [Aneks 35. Vendim per emerim koordinatori] [takim me stafin akademik].</p>   |                               |                         |          |                         |  |     |     |     |     |          |   |  |   |  |            |   |  |   |  |               |   |   |   |  |                    |   |   |   |   |     |   |   |   |   |  |          |          |          |          |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>   | <p>Për vitet akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 GVJ konstaton një menaxhim të duhur të stafit akademik PAE dhe PAK. Mbështetur në legjislacionin në fuqi, ku minimumi i kualifikimit që kërkohet për stafin akademik është Master i Shkencave, në përputhje me Ligjin 80/2015, neni 59, pika 6, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi (PAE dhe PAK) ka kualifikimin e nevojshëm:</p> <table border="1" data-bbox="638 1478 1340 1792"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Stafi i Programit të studimit</th> <th colspan="2">Viti akademik 2020-2021</th> <th colspan="2">Viti akademik 2019-2020</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Profesor</td> <td>1</td> <td></td> <td>1</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc</td> <td>1</td> <td></td> <td>1</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Doktor/Docent</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>-</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Msc (Dr në proces)</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>3</td> <td>6</td> <td>5</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td></td> <td><b>7</b></td> <td><b>7</b></td> <td><b>8</b></td> <td><b>3</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Ngarkesa mësimore e personelit akademik për programin e studimit me karakter profesional, referuar planit mësimor 2020-2022, duke marrë në llogaritje dhe intershipin është: 776 orë PAE dhe 310 orë PAK ose 71.4%</p> | Stafi i Programit të studimit | Viti akademik 2020-2021 |          | Viti akademik 2019-2020 |  | PAE | PAK | PAE | PAK | Profesor | 1 |  | 1 |  | Prof. Asoc | 1 |  | 1 |  | Doktor/Docent | 2 | 1 | - |  | Msc (Dr në proces) | - | - | 1 | 1 | Msc | 3 | 6 | 5 | 2 |  | <b>7</b> | <b>7</b> | <b>8</b> | <b>3</b> |
| Stafi i Programit të studimit   | Viti akademik 2020-2021   |                               | Viti akademik 2019-2020 |          |                         |  |     |     |     |     |          |   |  |   |  |            |   |  |   |  |               |   |   |   |  |                    |   |   |   |   |     |   |   |   |   |  |          |          |          |          |
|   | PAE   | PAK                           | PAE                     | PAK      |                         |  |     |     |     |     |          |   |  |   |  |            |   |  |   |  |               |   |   |   |  |                    |   |   |   |   |     |   |   |   |   |  |          |          |          |          |
| Profesor  | 1   |                               | 1                       |          |                         |  |     |     |     |     |          |   |  |   |  |            |   |  |   |  |               |   |   |   |  |                    |   |   |   |   |     |   |   |   |   |  |          |          |          |          |
| Prof. Asoc  | 1   |                               | 1                       |          |                         |  |     |     |     |     |          |   |  |   |  |            |   |  |   |  |               |   |   |   |  |                    |   |   |   |   |     |   |   |   |   |  |          |          |          |          |
| Doktor/Docent   | 2   | 1                             | -                       |          |                         |  |     |     |     |     |          |   |  |   |  |            |   |  |   |  |               |   |   |   |  |                    |   |   |   |   |     |   |   |   |   |  |          |          |          |          |
| Msc (Dr në proces)  | -   | -                             | 1                       | 1        |                         |  |     |     |     |     |          |   |  |   |  |            |   |  |   |  |               |   |   |   |  |                    |   |   |   |   |     |   |   |   |   |  |          |          |          |          |
| Msc   | 3   | 6                             | 5                       | 2        |                         |  |     |     |     |     |          |   |  |   |  |            |   |  |   |  |               |   |   |   |  |                    |   |   |   |   |     |   |   |   |   |  |          |          |          |          |
|   | <b>7</b>  | <b>7</b>                      | <b>8</b>                | <b>3</b> |                         |  |     |     |     |     |          |   |  |   |  |            |   |  |   |  |               |   |   |   |  |                    |   |   |   |   |     |   |   |   |   |  |          |          |          |          |

|  | <p>PAE dhe 28.6 % PAK.</p> <p>Kushti ligjor që PAE të angazhohet mbi 70% të ngarkesës plotësohet,</p> <p>Institucioni garanton një mjedis të duhur për sigurimin e programit mësimor. Infrastruktura e ngritur plotëson kushtet për salla leksioni, salla seminaresh dhe zyra të stafit akademik. Për aftësimin praktik janë në funksion laboratorë të cilët kanë një kapacitet të mjaftueshëm për të gjithë studentët në këtë program studimi. Në mbështetje të programit mësimor Institucioni angazhon edhe një staf administrativ dhe ndihmës akademik</p> <p>[Aneks 41. Tabelat permbledhese _ASCAL MRK_.pdf]. [Takim me stafin akademik; vizitë në institucion].</p>                   |                      |                       |                      |                       |  |  |  |   |
|--|---|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p> | <p>Institucioni mbështet dhe inkurajon kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Institucioni krijon mundësi aplikimi në programin double degree të doktoraturës. Thirje në lidhje me pjesëmarrje në konferenca dërgohen tek stafi akademik dhe inkurajohet pjesëmarrja e tyre. Për aftësimin në fushën profesionale shfrytëzohen edhe projektetku përmendim Drive Project: Training workshop. Institucioni inkurajon edhe stafin PAK.</p> <p>Në takimin e zhvilluar me stafin akademik pedagoge PAK dëshmuar për mbështetjen e tyre nga institucioni duke vënë në dispozicion ambiente laboratorike dhe plotësimin e çdo nevojë nga ana e tyre</p> <p>[Takim me stafin akademik].</p> |                      |                       |                      |                       |  |  |  |   |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>  | Nuk përmbushet       | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |  |  |  | X |
| Nuk përmbushet   | Përmbushet pjesërisht   | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |                      |                       |  |  |  |   |
|  |   |                      | X                     |                      |                       |  |  |  |   |

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional**

| Kriteret  | Vlerësimi  |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> | <p>Universiteti POLIS vë në dispozicion një infrastrukturë të duhur për të garantuar programin mësimor MRK. Ndërtesa përbohët nga tre kate secila me një sipërfaqje totale 11,020 m<sup>2</sup>. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me mjetet didaktike që mundësojnë një proces mësimor në përputhje me standartet. Në strategjinë e zhvillimit 2014-2020 Institucioni synon forcimin e mjediseve laboratorike, duke synuar edhe ne ofrimin e shërbimeve ndaj të treëve. Konkretisht U_POLIS ka 6 laboratorë të shfrytëzueshëm për qëllime didaktike dhe kërkimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Laboratori i Mjedisit</li> <li>2. Laboratori i GIS/CAD/SAP/ETABS/TEKLA</li> <li>3. Laboratori i MAC</li> <li>4. Laboratori i Eficiencës Energjitike</li> <li>5. Laboratori i Prototipizimit</li> </ol> |

|  |  |
|--|--|
|  | <p>6. Laboratori i Shkencave Kompjuterike</p> <p>Për këtë program studimi është në funksion edhe laborator i dedikuar ICT e pajisur me software dhe hardware të duhur për të siguruar aftësimin praktik të studentëve. Numri i posteve në laborator e tejkalon numrin e studeteve në vitin e parë dhe të dytë në këtë program studimi</p> <p>[Aneks 39. U_POLIS_Raporti Vjetor 2019-2020.pdf], [vizitë në institucion].</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> | <p>U_POLIS siguron mjedisë mësimore të duhura për procesin mësimor. Veprimtaria mësimore zhvillohet në klasat e vendosura në katin zero të cilat kanë një sipërfaqje 75m<sup>2</sup> -120m<sup>2</sup> të adoptueshme në klasa leksioni dhe seminare, në funksion të numrit të studentëve. Në katin e parë janë të vendosur edhe laboratorët të cilat janë të pajisur me të gjithë pajisjet dhe software dhe për garantimin e funksionit të tyre është në shërbim edhe njëësia e IT. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pozicionuar në katin e parë dhe të dytë përkatesisht me sipërfaqje që variojnë nga 52-142 m<sup>2</sup> dhe 66-216m<sup>2</sup>. Laboratorët dhe auditoret janë të pajisur me printer, lazer, skaner, projektorë etj duke mundësuar një zhvillim interaktiv të procesit mësimor. Për vitin akademik 2020-2021 si pasoje e situatës së COVID-19, laboratorët morën edhe një funksion të veçantë në drejtim të zhvillimit të praktikave profesionale.</p> <p>[Vizite në institucion]. [Takim me stafin akademik].</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>           | <p>Institucioni garanton një mjedis laboratorik në përputhje me standartet dhe që garanton aftësimin praktik të studentëve. Për këtë program studimi është në funksion edhe laborator i dedikuar te ICT e pajisur me software dhe hardware të duhur për të siguruar aftësimin praktik të studentëve. Numri i kompjuterave në laborator e tejkalon numrin e studentëve në vitin e parë dhe të dytë në këtë program studimi.</p> <p>[Vizitë në institucion].</p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>   | <p>Në funksion të programit të studimit MRK, U_POLIS ka vënë në dispozicion edhe 3 laboratorë të pajisur me software/hardware të duhur që mundësojnë plotësimin e objektivave të moduleve të programit mësimor. Në funksion të programit është laborator i dedikuar ICT i pozicionuar në katin e tretë dhe i ngritur me fonde të universitetit në vitin 2019. Laboratori ka 31 kompjutera për studentët dhe 1 kompjuter për stafin akademik. Laboratori është i pajisur me software e duhur (Eclipse, Packet Tracer, Wireshark, SPSS) që plotësojnë edhe kërkesat e disa moduleve në këtë program studimi. Në funksion janë edhe baza hardware për realizimin e orëve praktike. GVJ konstaton routera adds, koka rrjeti, kabuj, lloje të ndryshme switch, rack, sfp, konektore etj.</p> <p>Nga vizita në këtë laborator GVJ evidentoi që sipërfaqja e laboratorit, mjedisi për zhvillimin e pjesës teorike dhe aneksi për zhvillimn e orëve praktike ishte i mire organizuar duke harmonizuar teorinë me praktikën.</p> <p>[Aneks 39. U_POLIS_Raporti Vjetor 2019-2020.pdf; vizitë në institucion]</p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me</p>   | <p>Nga vizita në institucion, bazuar edhe në dokumentacionin dhe takimet me</p>  |

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional. | <p>stafin akademik dhe drejtues të institucionit, GVJ konkludon që mjediset për zhvillimin e procesit mësimor në këtë program studimi MRK janë të ngritura, në funksion të programit dhe në përmiresim të vazhdueshëm i cili kryhet mbi bazën e një strategji zhvillimi dhe kërkimit të Institucionit. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkepunimi me kompani biznesi për kryerjen e praktikave profesionale. Shembuj u dhanë në takime për kompanine CSP e cila ofron mbështetje me bazë materiale dhe burimet njerëzore (4 inxhinierë rrjeti me eksperiencë) dhe garantimin e intershipit të studentëve në këtë program studimi</p> <p>[Takim me stafin akademik].</p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Përmbyshet plotësisht</b>   | <b>Përmbyshet pjesërisht</b> | <b>Përmbyshet kryesisht</b> | <b>Përmbyshet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | X                            |

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij**

| Kriteret  | Vlerësimi   |
|---|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | <p>U_POLIS ka vënë në dispozicion bibliotekën mësimore e pozicionuar në katin e parë dhe me një sipërfaqje 155 m<sup>2</sup> Biblioteka siguron kushte të favorshme të studentëve dhe një akses pa pagesë të literaturës që i vihet në dispozicion. Në bibliotekë si rrjedhojë e shumëllojshmërisë që ofron janë përfshirë periodikë të ndryshëm të shkruar dhe elektronikë të revistave më influencuese shkencore të momentin.</p> <p>Në funksion të studentëve është edhe salla me kompjutera me sipërfaqje 23 m<sup>2</sup> e cila i mundëson ata të studiojnë dhe të zhvillojnë detyrat e kursit apo projektet e kërkua. Biblioteka funksion mbi bazën e një rregullore të menaxhimit dhe administrimit të fondit të librave</p> <p>[Vizitë në institucion; Aneks 33. Kërkesë për hapjen e programit.pdf] [takim me përgjegjësen e bibliotekës].</p>  |
| <b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.  | <p>Biblioteka e U_POLIS ka një fond aktual prej 10,000 titujsh në përputhje me programet që ofron duke qënë kështu një bibliotekë shumë e pasur për këto disiplina. Biblioteka ka literaturë të mjaftueshme dhe të shumëllojshme e cila i vjen në ndihmë studentëve që dëshirojnë të përdorin këto burime për realizimin e projekteve, kërkimeve shkencore dhe përgatitjen e tezave U_POLIS</p> <p>Biblioteka ka një fond literature në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj në fushën e moduleve të ofruara në këtë program studimi. Literatura është e pozicionuar në raftet e para në hyrje të bibliotekës së bashku me dispencat e leksioneve. Një punë e madhe po bëhet në sigurimin e literaturës në gjuhën shqipe. Departamenti i Kërkimit të Aplikuar zhvillon një punë serioze në lidhje me pasurimin e bibliotekës me literaturë në funksion të programit të studimit. Kërkesa buron nga literatura e detyruar dhe suplementare e vendosur në syllabuse nga stafi akademik. Çdo vit bëhet përmirësimi i syllabuseve dhe mbi bazën e tyre përgatitet edhe lista e literaturës së deklaruar në to e cila më pas vijon me miratimin nga Dekani I Fakultetit të</p> |

|   |   |
|---|---|
|   | <p>Kërkim dhe Zhvillimit dhe nga përgjegjësi i bibliotekes dhe sektori i financës. GVJ evidentoi në bibliotekë një literaturë bashkëkohore të viteve të fundit të cilat mbulojnë kërkesat për këtë program studimi.</p> <p>[Raporti vjetor 20109-2020].</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>   | <p>Situata e krijuar nga COVID -19 ka sjellë edhe një rritje të angazhimit të stafit të bibliotekës në shërbim të studentëve. Gjatë vitit akademik 2019 – 2020 Institucioni ndër morri edhe masa të duhura duke bërë të mundur që studentët të kenë akses dhe të mund t'i përdori këto dy e-library (të pasura me literaturë të kategorive të ndryshme ndërkombëtare) për të thelluar njohuritë dhe dijet në fushat e tyre të interesit. Për këtë është realizuar abonimi në dy bibliotekat ndërkombëtare online EBSCO dhe JSTOR e-library të cilat u konsideruan shumë efektive gjatë situatës së pandemie.Manualet e përdorimit të tyre janë të pasqyruara edhe në website, duke mundësuar një informim të studentëve në lidhje me përdorimin e tyre, <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1335">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1335</a></p> <p>Institucioni synon në pasurimin i vazhdueshëm të Bibliotekës nëpërmjet blerjeve, donacioneve nga partnerë (i.e UNIFE) dhe botimeve të stafit të U_POLIS (Aneks 4, Broshura e Bibliotekës). Institucioni organizon fushatën “Dhuro një Libër @ POLIS” e cila është nje forme e socializimit dhe kontributit të studentëve dhe komunitetit në drejtim të pasurimit te Bbliotekës [<a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1335">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1335</a>].</p> <p>Marrëveshja e bashkëpunimit me Universita IAUV, Venecia, Itali ka në fokus të saj dhurime librash për Biblio_Polis. Monitorimi i punës në pasurimin e bibliotekës është pjesë e raportit vjetor që U_POLIS harton në fund të çdo viti akademik.</p> <p>[Vizitë në bibilotekë]. [Aneks 6. Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit.pdf] [Aneks 39. U_POLIS_Raporti Vjetor 2019-2020.pdf].</p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojnë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p> | <p>Në funksion të programit mësimor Institucioni ka nënshkruar shumë marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të Arsimit te Larte me shumë vende partnere në shkëmbim të informacioneve dhe njohurive teknike Në drejtim të zhvillimit të praktikave profesionale po bëhet një punë intesive duke konsideruar që programi MRK është tashmë i ri. Kompania CSP ka dhënë një kontribut në kuader të realizimit të intershipit dhe ka ofruar pajisje si telefoni fikse, fribra, splicer etj për plotësimin me pajisje hardware të laboratorit të dedikuar ICT duke mundësuar realizimin e praktikave.</p> <p>[Aneks 6. Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit.pdf]. [takim me drejtues të njësisë kryesore dhe bazë]</p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>   | <p>Në drejtim të financimit U_POLIS ndonëse me status ligjor është një institucion privat nuk e konsideron veten si një institucion me qëllim fitimin por si një organizatë që siguron një panvarësi intitucionale në terma sasior dhe cilësor të saj. Programi MRK është një program i ri i cili ka një mbështetje të plotë financiare nga institucioni. Duke konsideruar që U_POLIS është një institucion privat i menaxhuar nga një Bord Partnerësh, operon me nje sistem 3 vjeçar buxhetimi afatmesëm dhe nje buxhetim vjetor që diskutohet dhe aprovohet nga Bordi (4 anëtare). Pas aprovimit paraprak të tij është zyra e financës e cila ka në fokus implementimin e</p>   |

|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|   | <p>aktiviteteve financiare Institucioni është subjekt i auditimit të realizuar nga një shoqëri e jashme e panvarur auditimi.</p> <p>[Aneks 47. Politika e financimit.pdf]. [Aneks 37. Raporti i auditimit i pasqyrave financiare 2017 POLIS.pdf]</p>  |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p> | <p>Institucioni garanton një financim të qëndrueshëm të programit mësimor duke mbuluar edhe kostot dhe shpenzimet që ky program ka në fillimin e tij. GVJ nuk gjeti të dhëna të dokumentuara në lidhje me shpenzimet e bëra në këtë program për vitin financiar 2020-2021 por takimet garantuan një stabilitet financiar të programit të studimit.</p> <p>Kostot e programit MKR mbulohe nga të ardhurat e shkollimit që paguajnë studentët e regjistruar. Për vitin akademik 2019-2020 kostoja e plotë ka qenë 2.5 milione lekë ku 60% zënë kostot e drejtpërdrejta dhe 40% janë kosto administrimi dhe didaktike.</p> <p>Institucioni ka investuar në këto dy vite në drejtim të përmirësimit të laboratorëve dhe hapjes së laboratorit të dedikuar ICT. Konkretisht ky laborator u hap në vitin 2019 me një vlerë investimi fillestar 50,000 EUR. Institucioni synon në diversifikimin e burimeve financiare në këtë program studimit.</p> <p>[Aneks 39. U_POLIS_Raporti Vjetor 2019-2020.pdf, faqe 21-22; takim me drejtues të njësisë kryesore dhe bazë] [RVB_MRK_POLIS_IT_24.03.2021_Scan.pdf].</p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Plotë përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |   |                              |                             | X                            |

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

| Kriteret   | Vlerësimi   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> | <p>Kriteret e pranimit të studentëve në programin MRK janë në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë, dispozita ligjore të MAS. Kriteret e pranimit vendosen nga U_POLIS dhe miratohen nga MAS.</p> <p>Kriteret e pranimit janë të percaktuar në Nenin 5 të Rregullores së programit të studimit. Kriteret e pranimit miratohen çdo vit nga MAS dhe bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit, <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33</a>.</p> <p>Departmenti i Kërkimit të Aplikuar ndjek progresin e studentëve gjate vitit akademik. Në Rregulloren e Programit të Studimit janë të percaktuar qartë detyrimet që studenti duhet të plotësojë. Në fillim të çdo moduli studenti njihet me formën e vlerësimit të njohurive të cilat janë të shprehur qartë edhe në syllabuse Stafit akademik ofron asistencë studentëve veçanërisht gjatë situatës së Covid-19</p> <p>U_POLIS ka ngritur Zyrën e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës e cila ofron asistencë studentëve në lidhje me praktikat profesionale (shembull u dha ne takim me përfaqësues të kësaj zyre me kompaninë Abissnet</p> |

|  |  |
|--|--|
|  | <p>ku 2 studentë kryen edhe praktikën profesionale) dhe i mbështet ato gjatë studimeve të tyre. Ndër veprimtarite e saj përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Informimi i studentëve dhe sigurimi i transparencës së plotë për çështjet e aspektet akademike, mësimore dhe shkencore si dhe me të drejtat e detyrat e tyre;</li> <li>• Orientimi i studentëve në shkollimin dhe gjatë shkollimit për zgjedhjen e fushave formuese specifike dhe mundësive të formimit që ofron universiteti.</li> </ul> <p>[Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar).pdf]. [Aneks 10. Syllabuse MRK.pdf]. [Takim me studentët].<br/> <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57</a></p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>   | <p>Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta bëhen të njohur tek çdo kandidat që kërkon të studiojë në U_POLIS. Kriteret miratohen nga MAS dhe publikohen në website të Institucionit. [<a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33</a>].</p> <p>Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit janë të shprehur në nenin 5, 6 të Rregullores së Programit të studimit, ku kriteri kryesor është përfundimi I Maturës shtetërore, ose nëse kandidatët zotërojnë diplome ekuivalente me të. Ndër kriteret e veçanta përmendim: Mesatarja minimale e përcaktuar nga MASR – kriter përjashtues;</p> <p>[Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar).pdf]</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p> | <p>U_POLIS ka të ngritur të gjithë strukturat dhe mekanizmat në shërbim të informimit të studentëve, ofrimit të asistencës dhe monitorimit të progresit të tyre, keshillimit në drejtim të karrierës dhe punësimit.</p> <p>Njesia baze dhe stafi akademik informojnë studentët në lidhje me procesin mësimor. Stafi akademik vë në dispozicion të studentëve materialet e leksioneve, përmbajtjen e orëve laboratorike, skripte dhe çdo material shtesë që mund të nevojitet tek studenti. Në takimin e bërë me stafin akademik u theksua veshitërsia e sigurimit të materialeve në gjuhën shqipe. Duke konsideruar që MKR është një program i ri stafi akademik ka bërë punë serioze në lidhje me adoptimin e materialeve dhe përshtatjen e tyre për programe dy-vjeçare. Kontribut në këtë drejtim kanë dhënë edhe stafi akademik PAK i angazhuar. U theksua shfrytëzimi i bibliotekave si psh e Universitetit “Aleksander Moisiu” Durrës për të siguruar material suplementare për studentët.</p> <p>Njësia bazë kontrollon vlerësimin e dijeve të studentëve dhe progresin e tyre e shpreh në raportet vjetore.</p> <p>ZMSKK ofron orientim dhe njohje të studentëve me tregun e punës në përgjithësi dhe mundësitë e veçanta e të momentit për punësimin duke ndërmjetësuar këtë proces.</p> <p>[Raporti vjetor 2019-2020]. [takim me perfaqesues se ZMSKK]</p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve,</p>   | <p>Studentët janë informuar në lidhje me programin e studimit përmes aplikimit të tyre në U_POLIS Burimet e informimit janë të larmishme. Në këtë drejtim Institucioni përdor website, fletëpalosje, broshura publikime etj (POLIS @ a Glance, Guida e studentit etj). Struktura e programit të studimit është e publikuar</p>   |



| <p>mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>   | <p>në website, <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33</a>.</p> <p>Pedagogët informojnë studentët në lidhje me përmbajtjen e modulit dhe çdo leksion hidhet menjëherë pas mbarimit të tij në Google Classroom.</p> <p>Programi i studimit MRK ofron mundësi punësimi në një spektër të gjerë në fushën e mirembajtjes së rrjeteve kompjuterike dhe dhe zgjidhjen e problematikave në lidhje me netëorkun. Nga takimi me studentët shumica e tyre synonin në punësimin jashtë vendit në fushën e tyre të studimit. Ky synim me tepër kishte të bënte me mundësitë më të mira që ofrohen jashtë krahasuar me brenda vendit. PAGESA e ulët, KËRKESAT e punëdhënësit në shumicën e rasteve tejkalonin kriteret për vendin e punës vakant, ishin disa shembuj që ata sollën në këtë drejtim.</p> <p>[Takim me studentët]. [Aneks 24. Guida e Studentit.pdf].</p> |                       |                      |                       |  |  |   |
|---|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Institucioni informon studentët për përmbajtjen e programit të studimit dhe detyrimet përmes dokumentave baze ligjore: Rregullore e Programit të Studimit. ZMSKK luan një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve dhe ofrimin e asistencës teknike. Staf i akademik mbështet punën e studentëve. Orë suplementare ndërmerren nga ata dhe sqarime shtesë ofrohen për tema të veçanta</p> <p>Syllabuset dhe përmbajtja e programit të studimit janë të pasqyruar në website. Institucioni vë në dispozicion një staf administrativ dhe ndihmës akademik për orët e laboratorit dhe çdo ndihmë në sigurimin e materialeve shtesë që studentit i nevojitet. Biblioteka është në shërbim të studentëve edhe në fundjavë.</p> <p>Sektori i IT i ngritur në U_POLIS mundëson një mirëmbajtje periodike të sallave të laboratorëve. [Takim me studentët].</p>  |                       |                      |                       |  |  |   |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>   | <p>U_POLIS ofron një sistem menaxhimi që buron nga njesia baze deri në instancat e larta të universitetit. Dokumentat bazë ligjore, informacioni bazë dhe njoftimet mbi aktivitetet, tarifat jepen në website: <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/56">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/56</a></p> <p>Platofoma ESSE3 mundëson regjistrimin e studentëve, njohjen me modulet, ngarkesën mësimore, oraret, grafikun e provimeve, regjistrimin në provim dhe marrjen e vlerësimit etj. Çdo student dhe staf akademik ka kredencialet personale të tij dhe sistemi ofron një fleksibilitet në aksesimin e tij.</p> <p>[<a href="https://www.upolis.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.upolis.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a>].</p>   |                       |                      |                       |  |  |   |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="518 1489 710 1556">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="710 1489 885 1556">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="885 1489 1428 1556">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="518 1556 710 1601"></td> <td data-bbox="710 1556 885 1601"></td> <td data-bbox="885 1556 1428 1601" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>  | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |  |  | X |
| Përmbushet pjesërisht   | Përmbushet kryesisht  | Përmbushet plotësisht |                      |                       |  |  |   |
|   |   | X                     |                      |                       |  |  |   |

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional**

| Kriteret  | Vlerësimi   |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me</p> | <p>Në U_POLIS është ngritur një sistem i organizuar informacioni për të transmetuar tek studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 [04] 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 33

|  |  |
|--|--|
| <p>studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>   | <p>institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj. Informacioni i nevojshëm publikohet në disa forma:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• letër, në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, procedurave, etj, të cilat gjënden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve.</li> <li>• letër të shpallura në mjediset e përcaktuara të Universitetit, si orari i mësimit, njoftime të ndryshme, pjesë të rëndësishme të rregullores, rezultatet e kontroleve, etj.</li> <li>• elektronik në faqen zyrtare të universitetit, e cila është e aksesueshme nga studentët në mjediset e universitetit dhe jashtë tij.</li> </ul> <p>Të dhenat e studentëve së bashku e dosjet personale të tyre ruhen në sekretarinë mësimore në formëhardcopy dhe elektronike. Të dhënat e stafit akademik ruhen në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Progresi i studentëve monitorohet nga stafi akademik dhe njësia bazë. Progresi i tyre shprehet në formen e raporteve vjetore ku evidentojmë perpunimin statistikor të t dhëve t mbledhura.</p> <p>Studentët me regjistrimin e tyre në MKR regjistrohen edhe në platformën ESSE3 përmes të cilës kanë mundësi të marrin informacion për lëndët, ngakesën mësimore, oraret, detyrimet, vlerësimin gjatë vitit dhe në provim. Kjo platformë u shërben studentëve të bëjnë edhe vlerësimin e tyre për pedagogët e lëndës dhe informacioni më pas vijon me përpunimin analitik nga zyra e NJSBC.</p> <p>Platforma të posaçme përdoren në bibliotekë për regjistrimin e përdoruesve, arkivimin administrimin e fondit të librave etj. Institucioni u kushton vëmendje ruajtjes së punimeve në përputhje me afatet e përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Institucionit.</p> <p><b>[Aneks 4. Rregullore e Përgjithshme, neni 93]</b></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> | <p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për administrimin e dosjeve personale të stafit akademik, ndihmës-akademik dhe administrative. Kontrata e punës janë të hartuara në përputhje me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë duke pasqyruar qartë përgjegjësitë midis palëve, ngarkesën mësimore, lëndet që mbulohen dhe afatet kohore.</p> <p>Platforma ESSE3 krijon fleksibilitet për stafin akademik për të pasqyruar vlerësimin e studentëve, sallat e leksioneve, oraret e mësimore dhe çdo njoftim të nevojshëm. Komunikimi i brendshëm i personelit është efektiv dhe realizohet përmes llogarive vetjake që secili disponon.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>  | <p>Studentët mund ta aksesojnë sistemin e menaxhimit përmes faqes zyrtare të U_POLIS. Ata kanë akses për të parë syllabuset e lëndëve, orarin, mungesat, vlerësimet gjatë vitit, notat përfundimtare, njoftime të ndryshme nga sekretaria, etj. Në sistemin e menaxhimit të U_POLIS ruhen të gjitha të dhënat personale, për çdo pedagog të angazhuar në programin EE; secili prej tyre akseson sistemin me kredencialet që i vihen në dispozicion. Nëpërmjet sistemit stafi akademik, hedh vlerësimet e vazhdueshme të studentëve, vlerësimet e ndërmjetme si edhe ato finale, përditësojnë</p>   |

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|   | syllabuset, gjenerojnë procesverbalet etj.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.                             | U_POLIS përdor një seri platforma online për të garantuar një komunikim efektiv midis stafit akademik dhe studentëve. Platforma ESSE3, Google Classroom shërbejnë informimin e studentëve, pajisjen e tyre me leksione, ushtrime, dorëzimin e detyrave dhe projekteve të kursit etj. Për shkak të situatës së vështirë të krijuar nga COVID-19, Institucioni dha një mbështetje të madhe zhvillimit efektiv të leksioneve online. Platforma Google Classroom ka shërbyer edhe për zhvillimin e provimeve online përmes garantimit të ruajtjes së anonimatit dhe eliminimit të formave të kopjimit.<br><br>[Takim me studentët; Aneks 44. Regjistrimi online i studentëve ne provime.pdf; Aneks 43. Regjistrimi online i Studentëve.pdf]. |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.       | Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e specifikuar në Rregulloren e Përgjithshme, çdo strukturë e ngritur është e aftë të mbledhë dhe të përpunojë në kohë reale raportet në lidhje me programin e studimit, ecurinë e tij, progresin e studentëve, problematikat e hasura dhe të ofrojë rekomandime të vlefshme për përmirësimin e tyre.<br><br>[Aneks 4. Rregullore e Përgjithshme].  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. | U_POLIS ka faqen e tij zyrtarë e cila përmes rubrikave të veçanta ofron informacion të përditësuar në lidhje me programin mësimor, tarifatat, formularin e aplikimit, aktivitetet studentore, njoftimet për konferenca dhe thirrjet n' projekte kërkimore shkencore<br><br>[ <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/">http://www.universitetipolis.edu.al/</a> ].  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | X                            |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>  |  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | X                            |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

**Standardi V.1** Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit

| Kriteret   | Vlerësimi  |
|--|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të | Institucioni ka të përcaktuar qartë kriteret e pranimit dhe transferimit të studentëve. Në Rregulloren e Përgjithshme, Kreu III, Programet e Studimit me Karakter Profesional, neni 34 dhe 35 japin kriteret e pranimit të studentëve, ndërsa Kreu V-Transferimet përcaktojnë kriteret për transferimin e studentëve. Në Rregulloren Didaktike të Universitetit janë dhënë të gjithë kriteret që studenti duhet të plotësojë për programin mësimor. Regullorja e |

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 [04] 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 35

|   |  |
|---|--|
| <p>diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>  | <p>Programit të Studimit përcakton qartë edhe detyrimet e studentit në MKR.</p> <p>Rregulloret dhe procedurat që Institucioni zbaton në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve, vlerësimin dhe transferimin e tyre janë në përputhje me kuadrin logjor dhe udhëzimet e MAS.</p> <p>[Aneks 4. Rregullore e Pergjithshme.pdf; Aneks 20. Rregullore Didaktike.pdf; Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar).pdf;]</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>   | <p>Institucioni garanton barazinë e gjithsecilit për të punuar dhe studiuar pranë U_POLIS. Dokumenta bazë mbi të cilat Institucioni mbështet veprimtarinë e tij garantojnë mundësi të barabarta, eliminonjë diskriminin e të gjithë formave dhe synojnë që çdo student të aftësohet përmes asimilimit të dijeve dhe praktikës.</p> <p>Zyra e Mbështetje së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) ofron asistencë dhe këshillim të studentëve në drejtim të karrierës së tyre. Kjo zyrë ndjek studntët gjatë periudhës së studimit dhe gjurmon punësimit e tyre.</p> <p><a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57</a>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> | <p>Procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve në shkollën profesionale MRK, ato janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit, faqen zyrtare të POLIS, rrjetet sociale të universitetit, si dhe në Portalin U-Albania. Ato janë publike dhe përditësohen çdo vit akademik sipas legjislacionit në fuqi dhe dhe iu komunikohen kandidatëve potencialë gjatë vizitave paraprake në universitet.</p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>                | <p>GVJ konstaton se kriteret e pranimit, procedurat e përzgjedhjes së studentëve janë zbatuar me rigorizitet nga njësia bazë për këtë program studimi. Kriteret e pranimit të theksuara në Statut dhe në Rregulloren e Programit të Studimit janë të pasqyruar edhe në dosjen e aplikimit, i cili përmirësohet çdo vit nga Njësia Bazë. U_POLIS pasqyron në website përmbajtjen e programit mësimor MRK, stafin akademik të angazhuar</p> <p><a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33</a>.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit përcakton qartë tek studentët detyrimet që ata kanë në lidhje me programin. Studentëve u bëhen të qarta procedurat e përparimit akademik të tyre në fillim të çdo semestri akademik. Takimi me studentët evidentoi një informim të tyre në lidhje me kriteret e vlerësimit të detyrave, vlerësimi gjatë vitit nga ana e pedagogëve, vlerësimi në provim, procedura e ankimimit etj. Në Rregulloren Didaktike janë të përcaktuar qartë format e vlerësimit të dijeve të studentëve dhe kriteret për kalimin e tyre në vitin tjetër akademik. Konkretisht për programin MKR kriteret vijojnë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Frekuentimi është i detyrueshëm në masën jo më pak se 80% të numrit të seancave të zhvilluara, programet e studimit Master Profesional.</li> <li>• Mungesa në masën mbi 20% të numrit të seancave të zhvilluara në një lëndë (për programet e studimit Master Profesional), e shpall</li> </ul> |

|  | <p>studentin te paklasifikuar;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për të gjitha programet e studimit, studenti i vitit të parë kalon në vitin e dytë, nëse ai ka marrë jo më pak se 50% të krediteve (30 kredite) të vitit të parë.</li> <li>• Për studentët që transferohen në një nga programet e studimit të Universitetit POLIS, për të përlogaritur vitin në të cilin kandidati transferohet zbatohet vetëm kriteri i numrit total të krediteve të marra.</li> </ul> <p>Njësia bazë zbaton edhe kushte të veçanta pranimi për studentet të cilët nuk vijnë nga i njëjti Institucion i Arsimit të Lartë.</p> <p>[Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar), neni 8], [Aneks 12. Rregullore Programit të Studimit (e rishikuar).pdf], [takim me studentët] [Aneks 20. Rregullore Didaktike.pdf].</p>   |                      |                       |                      |                       |  |  |  |   |
|--|--|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>  | <p>Në fillim të çdo semestri studenti informohet në lidhje me kriteret dhe format e vlerësimit. Format e kontrollit të dijeve janë të përcatuar qartë në nenin 38 të Rregullores Didaktike. Kontrolli i dijes së një lënde bëhet sipas sistemit të deklaruar në syllabus i cili nga stafi akademik i vihet në dispozicion studentit në fillim të modulit. Në fillim të çdo semestri akademik studenti informohet në lidhje me kriteret e vlerësimit të tij të cilat janë të shprehur edhe në syllabuse. Nga takimi me studentët u konstatua informi i tyre në lidhje me provimet e pjesshme, detyrën e kursit dhe provimin final. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj me sistemin e notave (5 deri në 10).</p> <p>Studenti fiton të drejtën të marrë vlerësimin e një lënde, kur brenda afatit të parashikuar në grafikun e detyrimeve:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>ka plotësuar kriteret detyruese të vendosura për atë lëndë;</li> <li>e lejon tabela e varësisë së lëndëve;</li> <li>ka shlyer tarifat e shkollimit.</li> </ol> <p>[Neni 39 ne Rregulloren Didaktike]. [Takim me studentët, Aneks 10. Syllabuse MRK.pdf].</p> |                      |                       |                      |                       |  |  |  |   |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p> | <p>GVJ konstatoi se edhe sensibilizimi përmes përdorimit të rrjeteve sociale si facebook, instagram dhe website të UAMD-së janë disa forma përmes të cilëve studenti është njohur me programin e studimit dhe avantazhet në lidhje me punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve. Në këtë drejtim një rol të veçantë luan edhe ZMSKK.</p>   |                      |                       |                      |                       |  |  |  |   |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="558 1691 842 1758">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="842 1691 1013 1758">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1013 1691 1230 1758">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1230 1691 1444 1758">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>  | Nuk përmbushet       | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |  |  |  | X |
| Nuk përmbushet   | Përmbushet pjesërisht  | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |                      |                       |  |  |  |   |
|  |  |                      | X                     |                      |                       |  |  |  |   |

**Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit**

| Kriteret   | Vlerësimi   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit të karakter profesional.</p> | <p>Departamenti i Kërkimit të Aplikuar në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse si ZMSKK informojnë studentët në fillim të vitit akademik në lidhje me programin mësimor dhe detyrimet përkatëse që duhet të plotësohen nga studentët. Studentët njihen me Rregulloren e Institucionit, Rregulloren Didaktike dhe Rregulloren e Programit Mësimor MRK. Informacion jepet në lidhje me kohëzgjatjen, plotësimin e detyrimeve për të kaluar në vitin pasardhës akademik, frekuentimi i detyruar në masën 80%, zhvillimi i procesit mësimor në fundjavë, aksesimi në bibliotekë, zhvillimi i praktikave laboratorike dhe intershipi, projekti final etj. Në takimin me studentët përmes pyetjeve GVJ evidentoi që studentët janë të mirëinformuar për programin mësimor. Informimi i tyre në lidhje me përmbajtjen e çdo lënde është sanksionuar edhe në nenin 26, pikë 19 të Rregullores Didaktike. Pedagogët e çdo lënde presantojnë tek studentët syllabusin, përmbajtjen e lëndës dhe i pajisin ata në fund të çdo orë mësimi me leksione të cilat hidhen në classroom. Në lidhje me orët laboratorike, studentët marrin materialin përpara zhvillimit të saj dhe njihen me përmbajtjen e orës që do të zhvillohet [takim me studentët]. Studentët janë pjesë e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor.</p> <p>Institucioni pasqyron përmbajtjen e programit mësimor MRK edhe në website. Informacion për oraret, lëndet, sallat ku do të zhvillohet procesi mësimor jepen përmes platformës elektronike ESSE3.</p> <p>[Aneks 20. Rregullore Didaktike.pdf] [takim me studentët]</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikën profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>                                     | <p>Zhvillimi i praktikës profesionale është pjesë e programit mësimor MRK. Organizimi i praktikës profesionale miratohet nga drejtuesi i njesise baze. Konkretisht programi MRK zhvillohet në dy vite akademike me fokus të veçantë në aftësimin praktik të studentëve. Raporti teori / praktikë është pothuaj i njëjtë ndonëse në përmirësimet e vazhdueshme vëmendje e veçantë nga ana e institucionit i jepet rritjes së orëve të praktikës. Konkretisht bazuar në ngarkesën totale në auditor në programin MRK, rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksionet - 300 orë mësimore në auditor</li> <li>• Seminaret - 190 orë mësimore në auditor</li> <li>• Laboratorët - 432 orë mësimore në auditor</li> <li>• Ushtrimet/Detyrat - 24 orë mësimore në auditor</li> <li>• Praktikrat - 140 orë në auditor</li> </ul> <p>Programi profesional MRK përfshin 2 lëndë: Praktika Laboratorike (12 ECTS) dhe 2 Intership-e (6 ECTS secila), si dhe një Projekt Final (6 ECTS).</p> <p>Për zhvillimin e praktikave janë hartuar edhe syllabuse të veçanta të cilat janë subjekt i përmirësimit të vazhdueshëm</p> <p>Zyra e ZMSKK në bashkëpunim edhe me njësinë bazë janë përgjegjëse për organizimin e Intership-it. Konkretisht janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me ALBTELECOM, Telelink etj, për zhvillimin e praktikave profesionale. Duke konsideruar situatën e krijuar nga COVID-19, intershipi për vitin akademik 2019-2020 u zhvillua në mjediset e institucionit në bashkëpunim me kompaninë CSP e cila dha asistencë në sigurimin e shumë pajisjeve hardware që mundësuan edhe zhvillimin e orëve të praktikës nga ana e studentëve.</p> <p>[Aneks 20. Rregullore Didaktike.pdf, neni 6], [Aneks 14. Syllabus Praktike</p> |

|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|   | Laboratorike 1.pdf; Aneks 14.1. Syllabus Praktike Laboratorike 2.pdf]. [Takim me stafin akademik, takim me studentët].  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | <p>Institucioni garanton informimin e studentëve në lidhje me procesin mësimor. Kalendarit i mësimit dhe sallat e leksioneve bëhen të njohur tek studentët përmes komunikimit nga ana e koordinatorit të programit në platformën ESSE3. Një komunikim të vazhdueshëm dhe efektiv gjendet midis stafit akademik dhe studentëve. Në takimin e zhvilluar studentët sollën shembuj të informimeve të vazhdueshme nga ana e stafit akademik në lidhje me procesin mësimor, ndryshimet në orar, orët shtesë për sqarime etj.</p> <p>Gjatë vizitave fillestare nëpër kampus, ata njihen me të gjitha shërbimet e tjera që shkolla ofron, duke filluar me kancelarinë, sekretarinë, zyrën juridike, bibliotekën, kantinën. Studentët prezantohen me ambientet e Laboratorit, me rregullat përdorimit të aparaturave, me auditoret etj.</p>  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.          | <p>GVJ konstatoi se Institucioni përdor forma të larmishme në lidhje me shpërndarjen e informacionit tek studentët. GVJ konstatoi se të gjithë hallkat pjesë përbërëse e tij luajnë një rol në këte drejtim. Takimi me studentët tregoi një informim të qartë të tyre në lidhje me programin, përmbajtjen e tij, detyrimet dhe përgjegjësitë përkatëse të studentëve dhe stafit akademik. Ndër hallkat më të rëndësishme vlen të përmenden:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shpërndarja e informacionit [udhëzime nga Rektorati, Dekanati dhe nga MAS] nga koordinatori i programit përmes komunikimit të drejtpërdrejtë dhe në bashkëpunim me stafin akademik.</li> <li>2. Informacion në lidhje me kurrikulën dhe detyrimet përkatëse të studentëve jepet nga stafi akademik;</li> <li>3. Informacion në lidhje me regjistrimin, numrin e matrikulës së studentit, vlerësimet në provime, oraret, pagesat jepen në ESSE3;</li> <li>4. Informacion në lidhje me punësimin merret nga stafi akademik dhe zmkss;</li> </ol> <p>Informacioni shpërndahet edhe në formë on-line përmes uebsite <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/">http://www.universitetipolis.edu.al/</a>, përmes facebook, instagram, etj.</p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Plot përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |   |                              |                             | X                            |

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

| Kriteret   | Vlerësimi   |
|--|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit. | Të dhënat në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar, transferuar dhe progresin e tyre deri në përfundim të studimeve mbahen në Sekretarinë Mësimore. GVJ kreu një vizitë në ambientet e Sekretarisë mësimore dhe konstaton se dosjet personale të studentëve të regjistruar, të transferuar janë konform rregullores së institucionit dhe në përputhje me kornizën ligjore të |

|  | <p>kërkuar nga MAS</p> <p>Të dhënat për studentët e regjistruar mbahen në hardcopy dhe në forme elektronike [Vizitë në sekretarinë mësimore].</p>   |                    |                                 |                         |                             |                         |           |    |     |   |   |           |    |      |   |   |
|--|---|--------------------|---------------------------------|-------------------------|-----------------------------|-------------------------|-----------|----|-----|---|---|-----------|----|------|---|---|
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> | <p>GVJ konstatoi se institucioni mban të dhëna periodike dhe vjetore në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar, të transferuar, të diplomuar. Sekretaria Mësimore e cila në bazë të rregullores së brendshme të saj dhe bazuar edhe në udhëzimet e MAS përdor rregjistra të veçantë për regjistrimin e studentëve me një numër të veçantë përkatës matrikulimi, realizon hedhjen e notave në rregjistrin e notave dhe përdor rregjistrin për studentët e diplomuar.</p> <p>Nga të dhënat e gjetura në këtë zyrë GVJ konstaton si vijon më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="603 611 1370 770"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar për herë të parë</th> <th>Mesatarja në hyrje</th> <th>Nr. studentë të transferuar</th> <th>Nr. studentë të larguar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>30</td> <td>6.2</td> <td>-</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>29</td> <td>6.18</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ konstaton se është ruajtur numri i studentëve të parashikuar në procesin e aplikimit për hapje të programit</p> <p>GVJ konstaton se nuk ka rënie të mesatares hyrëse dhe është ruajtur numri i studentëve të regjistruar për të dy vitet e para. Konkludojmë që bazuar në mekanizmat e informimit që Institucioni disponon, programi paraqet qëndrueshmëri në vazhdimësi e tij.</p> <p>[Aneks 33. Kerkese per hapjen e programit.pdf]. [Aneks 28. Të dhëna statistikore për studentët.pdf].</p> | Viti akademik      | Të regjistruar për herë të parë | Mesatarja në hyrje      | Nr. studentë të transferuar | Nr. studentë të larguar | 2019-2020 | 30 | 6.2 | - | 2 | 2020-2021 | 29 | 6.18 | - | - |
| Viti akademik  | Të regjistruar për herë të parë   | Mesatarja në hyrje | Nr. studentë të transferuar     | Nr. studentë të larguar |                             |                         |           |    |     |   |   |           |    |      |   |   |
| 2019-2020  | 30  | 6.2                | -                               | 2                       |                             |                         |           |    |     |   |   |           |    |      |   |   |
| 2020-2021  | 29  | 6.18               | -                               | -                       |                             |                         |           |    |     |   |   |           |    |      |   |   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>  | <p>Strukturat përkatëse të ngritura në U_POLIS menaxhojnë të dhënat e studentëve, kushtet e pranimi të tyre, progresin dhe diplomimin e tyre. Në strategjinë e zhvillimit 2016-2020 synohet që <i>“Të pajisë studentët e kërkuesit me dijë në përshtatje me kërkesat dhe problematikën në rritje për këto shërbime si dhe të garantojë standarte të larta e bashkëkohore duke synuar përshtatjen e specialistëve të kësaj shkolle jo vetëm brenda vendit por edhe në çdo vend tjetër jashtë Shqipërisë”</i>.</p> <p>Në përmbushje të objektivit Institucioni administron të dhënat e studentëve dhe ndjek progresin e tyre deri në përfundim të studimeve. Të dhënat paraqiten në raportet vjetore dhe bazuar në to njësisia bazë dhe kryesore ndërmerr edhe hapat përmirësuese</p> <p>ZMSKK mbledh të dhëna në lidhje me studentët e diplomuar dhe ndjek punësimin e tyre. Të dhënat ruhen në database dhe mban kontakte periodike me studentët duke bërë edhe përditësimin e saj. Programi profesional MRK akoma nuk ka krijuar brezin e pare të studentëve të diplomuar.</p> <p>Në Qershor 2019 është vendosur edhe platforma GRADUA (<a href="https://gradua.rash.al/">https://gradua.rash.al/</a>) e cila konsiston në integrimin e studentëve drejt mbylljes së studimeve në një hapësirë gjithëpërfshirëse me bizneset për të qenë me pranë tregut të punës</p>  |                    |                                 |                         |                             |                         |           |    |     |   |   |           |    |      |   |   |



|  |  |                                    |                                   |                                    |
|--|--|------------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| <p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>   | <p>U_POLIS ka vënë në funksion platforma të cilat mundësojnë një komunikim aktiv dhe garantojnë një shpërndarje të informacionit. Platformat mundësojnë edhe përpunimin statistikor të të dhënave në kohë reale. Bazuar edhe në Rregulloren e Përgjithshme strukturat e ngritura ne U_POLIS janë përgjegjëse dhe hartojnë raportet periodike dhe institucionale</p> <p>[Aneks 39. U_POLIS_Raporti Vjetor 2019-2020]</p>  |                                    |                                   |                                    |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> | <p>Sekretaria Mësimore e cila është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave në lidhje me studentët, përgatit raporte statistikore të cilat reflektohen edhe në raportin vjetor nstitutional që dorëzohet edhe në MAS. Në këto raporte paraqiten evidenca të mesatares në hyrje dhe në vite të studetëve, kalueshmëria, transferimet, largimet dhe diploma e studentëve në përfundim të studimeve të tyre.</p> <p>ZMSKK është struktura që gjurmon studentët dhe punësimin e tyre. Database e krijuar nga kjo zyrë përditesohet përmes takimeve që kjo srukturë mban me studentët e diplomuar.</p> |                                    |                                   |                                    |
| <p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>   | <p><b>Nuk përbushet</b></p>  | <p><b>Përbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përbushet plotësisht</b></p> |
|  |  |                                    |                                   | <p>X</p>                           |

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

| Kriteret  | Vlerësimi   |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>   | <p>Kreu X në Rregulloren e Institucionit shpreh qartë të drejtat dhe detyrat e studentëve. Studentët kanë përfaqësimin e tyre në Senatin Akademik i cili konsiderohet një organ kolegjiial vendimmarrës. Në U_POLIS studentët organizohen në Këshillin e Studentëve.</p> <p>Nga takimi me studentët në këtë program studimi GVJ konstatoi se nuk ka një pjesëmarrje në forume dhe këshilla studentore.</p> <p>[Aneks 4. Rregullore e Pergjithshme.pdf, neni 83] [takim me studentët].</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p> | <p>Bazuar në nenin 81 në Rregulloren e Përgjithshme çdo fakultet përfaqësohet me një student në Senatin Akademik</p> <p>Studentët marrin pjesë në procesin e përmirësimit të programit mësimor dhe japin lirshëm mendimin e tyre përmes pyetësorëve që Institucioni organizon për çdo lëndë në fund të semestrit.</p> <p>[Aneks 4. Rregullore e Përgjithshme.pdf, neni 81]. [takim me studentët].</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit,</p>         | <p>Stafi akademik i angazhuar për këtë program studimi në vijueshmeri zhvillon punë në lidhje me përmirësimin e përbajtjes së lëndëve pjesë përbërëse e këtij program. Në drejtim të përmirësimit merret mendimi nga progresi në ditët tona, eksperiencia e marrë nga pjesëmarrja ne trajnime dhe konferenca ndëkombëtare, mendimi nga kompanitëe biznesit me të cilat janë lidhur marrëveshje institucionale dhe nga vetë sugjerimet e studentëve në komuni-</p>                         |

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 [04] 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 41

|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.  | min e drejtpërdrejtë ose nga pyetsorët e plotësuar.<br>Ky përmirësim lehtëson ngarkesën teorike të studentëve dhe ka prioritet në zhvillimin më të madh të praktikës gjatë orëve laboratorike duke mundësuar një aftësim më profesional të tyre.<br>[3. Mendime_tregu i punes (1).pdf] [takim me stafin akademik].  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.   | Institucioni në fund të çdo semestri organizon sondazhe me studentët për të matur opinionin e tyre në lidhje me zhvillimin e programit të studimit. Studentët janë pjesë aktive në këtë drejtim. Sugjerimet, vërejtjet e paraqitura reflektohen në njësinë bazë në drejtim të përmirësimit të fushave që janë evidentuar problematike<br>Studentët edhe gjatë procesit mësimor shprehin mendimin e tyre në lidhje me procesin mësimor. Ndryshimet si reduktimi i kuadrit teorik dhe zhvillimi i me shumë orë praktike ose zhvillimi në auditor të lëndës në kushtet e pandemisë janë konsideruar nga stafi akademik<br>Pjese e procesit të përmirësimit të programit mësimor është edhe stafi akademik PAK. Ata kanë sjelle përvojën më të mirë të tyre dhe zhvillojnë një punë serioze në lidhje me përshtatjen e përmbajtjes së modulit për programet dy-vjeçare<br>[Takim me NJSBC]. [Takim me studentët]. [Takim me stafin akademik]. |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | GVJ konstatoi se institucioni i garanton studentit të shprehë mendimin, të marrë pjesë aktive në vlerësimin e procesit mësimor. Bazuar në aktet ligjore të shprehur në dokumentat bazë të institucionit studentët kanë të drejtën e vlerësimit të kontrollit të dijeve të bëra nga stafi akademik dhe të drejtën e ankimimit.<br>GVJ konstatoi në takimin me studentët se ata ishin të mirëinformuar në këtë drejtim ndonëse nuk u paraqiten shembuj në takimin e zhvilluar<br>[Takim me studentët].  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Niveli i përmbushjes</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |   |                              |                             | X                            |

### Standardi V.5

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

| Kriteret  | Vlerësimi   |
|---|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | U_POLIS ka krijuar Zyrën e Mbeshtetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK). Në fokus të punës së saj kjo zyrë ofron ndihmesë dhe asistencë tek studentët gjatë kohës së ndjekjes së studimeve dhe në bashkëpunim me njësitë bazë shërben si ndërmjetëse për të krijuar hapësira për praktika profesionale dhe punësim. |
| <b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një   | ZMSKK shërben edhe për të asistuar në jetën sociale me aktivitetet kulturore, sportive dhe artistike vjetore. Ngritja e kësaj struktura dhe funksioni i saj bëhet në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore në fuqi. ZMSKK është  |

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 [04] 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 42

|   |   |
|---|---|
| <p>sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> | <p>strukturë e panvarur në varësi të drejtpërdrejtë nga Rektori. Kjo zyrë zhvillon punën e saj në drejtimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Asistencë studenteve në lidhje me procesin mësimor. Kjo zyrë shërben për komunikimin e studentëve në lidhje me problematikat që ndeshen gjatë procesit mësimor dhe zgjidhjen e tyre përmes bashkëpunimit me hallkat përkatëse dhe njësinë bazë;</i></li> <li>• <i>Këshillim në lidhje me karrierën. ZMSKK zhvillon punë në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjeve institucionale me kompanitë e biznesit, këshillimin dhe trajnimet të studentëve si të hartojnë cv dhe mënyrën e përgjigjes në intervista të ndryshme;</i></li> <li>• <i>Ndjek ecurinë profesionale të të diplomuarve, duke gjurmuar punësimin e tyre në bashkëpunim me shoqatën Alumni</i></li> </ul> <p>[Aneks 39. U_POLIS_Raporti Vjetor 2019-2020.pdf]</p> |
|---|---|

|  |   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p> | <p>Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) vepron aktive në lidhje me informimin e studentëve për çështjet dhe aspektet mësimore. Gjithashtu, ajo informon studentët lidhur me tregun e punës dhe mundësi që ai ofron, duke luajtur rolin e ndërmjetësit në këtë mes.</p> <p>ZMSKK është orientuar drejt mbajtjes së kontaktit të vazhdueshëm si dhe dhënies së informacionit shumëdrejtimesh. Informacioni që kjo zyrë azhurnohet nga kontaktet me studentet e diplomuar (Alumni), të cilat shërbejnë për komunikim më të drejtpërdrejtë me ta.</p> <p>Në Qershor 2019 është vënë në funksion platforma Gradua, e cila mundëson një lidhje të studentit me kompanitë e biznesit në drejtim të punësimit të tyre përmes rritjes së aksesit në hapësirat e punësimit.</p> <p>ZMSKK përmbledh informacion për studime të mëtejshme, programe të ndryshme, orientim për karrierën ose orientimin profesional si dhe këshillim individual ose në grup.</p> <p>ZMSKK ka akumuluar, informacioni është vetë-deklarim i studentëve të diplomuar, mbledhur nëpërmjet një pyetësori që ZMSKK përdor për gjenerimin e informacionit nga ALUMNI, (Aneksin 8 – Pyetësor Alumni), nga ku përqindja e pyetësorëve të plotësuar deri me mbylljen e vitit akademik 2019-2020 rezulton të jetë 92%; e cila në shifra përkthehet në raportin: 1405/1528 studentë.</p> <p>[<a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57</a>].</p> <p>[<a href="https://gradua.rash.al/">https://gradua.rash.al/</a>] [Aneks 39. U_POLIS_Raporti Vjetor 2019-2020.pdf]</p> |
|--|---|

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|                                     |                       |                      | X                     |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|  |                       |                      | X                     |

## **Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Mirëmbajtje Rrjete kompjuterike” të Universitetit “POLIS”**

### **Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi profesional “Mirëmbajtje rrjete kompjuterike” zhvillohet në përputhje me politikat ndërkombëtare për forcimin e arsimit profesional.
2. U\_POLIS zotëron infrastrukturë bashkëkohore për të garantuar procesin mësimor në kuadër të programit MRK.
3. Natyra politeknike e U\_POLIS krijon një bazë solide për të garantuar vazhdimësinë e programit mësimor.
4. Programi profesional MRK siguron një punësim të studentëve në fund të studimeve të tyre.
5. Institucioni zotëron një staf akademik të specializuar dhe me eksperiencë në IT.
6. Bashkepunimi me kompanitë e biznesit garanton zhvillimin e praktikave profesionale duke përbushur objektivin për aftësimin në praktikë të studentëve.

### **Pika të dobta**

1. Përshtatja e kuadrit teorik për literaturën e detyruar në programin e studimit MRK.

### **Rekomandime:**

1. Të vazhdohet puna për përshtatjen/hartimin/përkthimin e teksteve mësimore për këtë program dy-vjecar;

## **Conclusions of the Evaluation of the Professional character study program in "Maintenance of computer networks" of "POLIS" University**

### **Strengths and affirmations**

1. The professional programme “Maintenance of Computer Network” (MCN) is developed in compliance with international policies for strengthening vocational education.
2. U\_POLIS posses a modern infrastructure which guarantees the education process within the frame of MCN programme.
3. The polytechnic nature of U\_POLIS establish a solid foundation to guarantee the continuity of the curriculum.
4. The professional program MCN guarantees employment to students at the end of their studies.
5. The institution engages specialized and experienced academic staff in field of IT.
6. The cooperation with business companies guarantees the development of professional practices by meeting the objective of practical training of students.

### **Weaknesses**

1. Adaptation of the theoretical framework for the compulsory literature in MCN

### **Recommendations:**

1. Continue work on adapting / drafting / translating textbooks for this two-year program.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT  | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS |                         |                        |                         |
|--|--|-------------------------|------------------------|-------------------------|
|  | Përbushen<br>në përgjithësi                    | Përbushen<br>pjesërisht | Përbushen<br>kryesisht | Përbushen<br>plotësisht |
| <b>I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b> |  |                         |                        | X                       |
| <b>II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>       |  |                         |                        | X                       |
| <b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>                            |  |                         |                        | X                       |
| <b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE</b>      |  |                         |                        | X                       |
| <b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>  |  |                         |                        | X                       |
| <b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>   |  |                         |                        | X                       |